4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**LOTI 1 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER QENDREN SPITALORE TE BURGJEVE**

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

LOTI 1 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER QENDREN SPITALORE TE BURGJEVE						
Nr.	Emertimi	Njësia	Sasia e pritshme e racioneve	Cmimi per njesi Lekë pa TVSH	Vlera e pritshme Leke pa TVSH	Afati I marreveshjes kuader
1	Dieta Nr.1 (Dieta normale) 2 700 k kal (prot100gr, lipide77gr, glucide 420)	rd	91,980			36 muaj
2	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget) 2100 k kal (prot 70 gr, lip.95.3gr, gluc.248.6gr)	rd	1,095			36 muaj
3	Dieta Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget) 2 100 k kal (prot.80 gr. Yndyrna 12gr. Gluc.297gr.	rd	1,095			36 muaj
4	Dieta NR 7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	rd	1,095			36 muaj
5	Dieta Nr. 9 (Dieta per enero-kolite) 2000k kal (prot.70gr. lip.63, gluc.308gr	rd	1,095			36 muaj

6	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike) Kjo diete varion nga 800-3000k kal, Dieta me diabetiket me diabet te ekuilibruar. (2 300 k kal (prot.88gr. lip.92gr. gluc.278gr)	rd	5,475			36 muaj
7	Dieta Nr.14 (Onkologe) Hiperkalorike,hiperproteinike,hi perglucidike e pasur me Ca e Fe 3 000 k kal (prot.122 gr. Yndyrna 108 gr. Gluc. 385gr.)	rd	7,665			36 muaj
Fondi i Marreveshjes Kuader per Lotin 1 Lekë (pa TVSH)					82,800,746	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**LOTI 2- SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER AKADEMINE E SIGURISE**

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

LOTI 2- SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER AKADEMINE E SIGURISE						
Nr	Emertimi	Njësia	Sasia e pritshme e racioneve	Çmimi per njësi Lekë (pa TVSH)	Vlera e pritshme Leke (pa TVSH)	Afati I marreveshjes kuader
1	Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Mëngjes	rd	198,075			36 muaj
2	Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Dreke	rd	304,025			36 muaj
3	Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Darke	rd	172,675			36 muaj
Fondi i Marreveshjes kuader për Lotin 2 Leke (pa TVSH)					173,506,269	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						

Çmimi total me TVSH:		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****LOTI 3 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER REPARTIN E
NDERHYRJES SE SHPEJTE SHKODER****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

LOTI 3 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER REPARTIN E NDERHYRJES SE SHPEJTE SHKODER						
Nr	Norma	Njësia	Sasia e pritshme e racioneve	Cmimi per njësi Lekë (pa TVSH)	Vlera e pritshme Leke (pa TVSH)	Afati I marreveshjes kuader
1	Norma me 3 Tre Vakte	Rd	21,900			36 muaj
2	Norma me 1 Vakt (Dreka)	Rd	47,025			36 muaj
Fondi total i marreveshjes kuader për Lotin 3 Leke (pa TVSH)					52,551,000	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						

	Vula		
	Datë _____		

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**LOTI 4 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER DREJTORINE
VENDORE TE POLICISE, TIRANE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

LOTI 4 - SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER DREJTORINE VENDORE TE POLICISE, TIRANE						
Nr .	EMERTIMI	Njesia	Sasia e pritshme e racioneve	Cmimi per njësi Lekë (pa TVSH)	Vlera e pritshme Leke (pa TVSH)	Afati I marreveshjes kuader
1	Ushqim i gatuar e shperndare	rd	38,800			
Fondi i marreveshjes kuader për Lotin 4 (Leke pa tvsh)					17,809,200	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						

Nëshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

**LOTI 1 - ME OBJEKT: "SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI",
PËR QENDRËN SPITALORE TË BURGJEVE**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Perberja e Dietave

DIETA NR.1 (DIETA NORMALE)

2700 k kal (prot 100 gr, lipide77 gr, glucide 420)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht	ml	300
2	Sheqer	gr	15
3	Buke	gr	250
4	Oriz,makarona	gr	150
5	Zarzavate	gr	500
6	Vaj	ml	30
7	Mish	gr	150
8	Fruta	gr	400
9	Djathe,gjize	gr	80
10	Gjalpe	gr	10

DIETA NR.4 (DIETA E LENGET)

2100 k kal (prot 70 gr, lip.95.3 gr, gluc.248.6 gr)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Sheqer	Gr.	60
2	Mjell orizi	Gr.	60
3	Vaj	MI.	30
4	Mish	Gr.	60
5	Biskota	Gr.	20
6	Krem qumeshti	Gr.	50

7	Xelatin frutash	Gr.	50
8	Veze	kokerr	1
9	Fruta	Gr.	500

DIETA NR.5 (DIETA E QULLET, 1/2 E LENGET)

2 100 k kal (prot.80 gr. yndyrna 12 gr. gluc.297 gr.)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	700
2	Sheqer	gr	60
3	Biskota	gr	100
4	Vaj	ml	30
5	Oriz	gr	50
6	Mish	gr	120
7	Patate	gr	200
8	Fruta	gr	400
9	Djathe	ml	30
10	Veze	koker	1

Dieta NR 7 Blanda(DIETA NE HEPATOPATIKE NE FAZEN AKUTE E SUBAKUTE)

2000k kal (prot.82gr. lip.16, gluc.265gr)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht /Kos	ml	1500
2	Sheqer	gr	20
3	Buke	gr	60
4	Oriz	gr	100
5	Gjalp	gr	20
6	Veze	keker	1
7	Patate	gr	250
8	Djath i njome	gr	70

Dieta Nr 9 (DIETA PER ENERO-KOLITE)

2000k kal (prot.70gr. lip.63, gluc.308gr)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Caj,leng frutash, caj, kamomil	ml	200
2	Sheqer	gr	10
3	Buke	gr	140
4	Oriz	gr	130
5	Gjalpe	gr	30
6	Mish	gr	100
7	Karota,patate	gr	400
8	Fruta	gr	200
9	Djathe	gr	100

DIETA NR.12 (DIETA DIABETIKE)

2300 kkal(prot.88g, lip 92 g, gluc 278 g)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	600
2	Buke	gr	150
3	Zarzavate	gr	500
4	Veze	koker	1
5	Djathe	gr	50
6	Gjalpe	gr	20
7	Oris	gr	100
8	Mish	gr	100
9	Vaj	ml	25
10	Fruta	gr	500

DIETA NR.14 (ONKOLOGE)**Hiperkalorike, hiperproteinike, hiperglucidike e pasur me Ca e Fe**

3000 k kal (prot.122 gr. ynd 108gr. gluc. 385 gr.)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	600
2	Mish	gr	200
3	Vaj	ml	30
4	Gjalpe	gr	15
5	Djadhe/gjize	gr	100
6	Veze	koker	1
7	Sheqer	gr	30
8	Oris	gr	110
9	Zarzavate	gr	500
10	Fruta	gr	400
11	Buke	gr	300

SPECIFIKIMET TEKNIKE MBI ARTIKUJT USHQIMORE

Lloji i mallit : **Buke gruri rreze 75**

Specifikimet teknike :

1. Buke e grurit do te prodhohet me miell rreze 75 %, i stazhinuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh..Mielli duhet te jete i fresket, me ngjyre, ere, shije dhe lageshtire konforme standarteve perkatese te miellit me rreze 75 %. Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj.
2. Buke duhet te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjeftueshem. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet te jete konforme standartit teknik te prodhiit te saj.

-Korja e bukes – duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte, ne te gjithe siperfaqen.

-Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithe vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura.
3. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku.

4. Treguesit fiziko – kimik:

-Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%.

5. Furnizimi i bukes do te behet jo me pak se 4 ore pas pjekjes. Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster dhe te siguroje mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.
6. Q.F.P.(sherbimi i Ushqimit) ka te drejte te kerkoje shoqerimin e bukes me çertifikate cilesie, sa here qe e shikon te nevojshme, por jo me shume se nje here ne tre muaj.
7. Buka duhet te jete e perer ne feta dhe e ambalazhuar ne qese plasmasi

Lloji i mallit: *Mish vici i fresket*

Specifikimet teknike:

1. Kerkohet mish gjedhi ne rritje (**vici**) qe te plotesoje kerkesat e standartit shteteror Nr 1441, te vitit 1987.
2. Raca e tyre te jete e ndryshme.
3. Kerkohet cilesia e pare sipas standartit dhe vetem kofshet e pasme
5. **Pamja e jashtme:**
 - Siperfaqja e jashtme te jete e mbuluar me nje cipe te holle tharje.
 - Siperfaqja e mishit te ftohur menjehere pas prerjes te jete i tejdukshem.
 - Tendinat te jene te ndritshme, elastike dhe te forta.
6. **Ngjyra:** Mishi te jete me ngjyre roze dhe i dhjemit te jete me ngjyre te bardhe.
7. **Konsistenca:** Te jete e bute dhe elastike. Ne prerje te duket kompakt.
8. **Era :** Te jete e kendshme, karakteristike e llojit.
9. **Palca e kockave :** Te mbushi te gjithë kanalën e palces, ngjyra te jete roze ne te verdhe.
10. Çdo kofshe, damkosen me vulen e kontrollorit veterinar e sanitar dhe me vulen e llojit e te cilesise se mishit.
11. Çdo parti mishi shoqerohet me çertifikaten veterinare me te cilen vertetohet gjendja e tij e mire shendetsore per shitje ne treg (konsum).
12. Peshimi i mishit ne depon e Q.F.P.do te behet jo me pare se 6 ore nga koha e therjes. Cdo parti furnizimi te jete vetem kofshe e pasme .

Lloji i mallit Salcice

Te jene te prodhuara nga firma prodhuese vendase,te certifikuara,te jene te shoqeruara me etiketen e prodhuesit.

Te jene me mish vici ose derri me ngjyre roze e celur,fundet te jene te lidhura mire,pamja e brendeshme ne prerje terthore te paraqes nje mase perzjerje te njetrajtshme,pa boshlleqe ajri,me

ngjyre natyrore te mishit te kuqe roze pa njolla te errata.Mishi dhe dhjami te jene te shperndara njelloje net e gjithë siperfaqen.

Qendrushermeria elastike dhe gjate shtypjes te mos ngelet shenja.Era e kendeshme karakteristike per erezat e perdorura,yndyrnat jo me shume se 23 % dhe kripa jo me shume se 2 – 3 %.

Ngarkesa mikrobike te jete Brenda normave te lejuara nga Instituti i shendetit Publik.

Te jene amballazhuar ne kuti kartoni 5 kg.

Cmimi perfundimtar dhe transporti me mjetet e shitesit.

Lloji i mallit: *Perime (bamje, bizezele bishtajore, domate, patellxhan, qepe e njome, qepe e thate, specat, laker, preshtetj).*

Bamja: Kerkohen te jene te fresketa,te shendosha,te pastra,me fije normale per kultivarin dhe fara qe duket lehte,me forme te drejte,lehtesisht te deformuar.Forma te jete e nje prizmi shumekendesh qe ngushtohet ne maje,te pa drunjezuar e pa fije.

-Gjatesia e cilesise se pare per bamjen frutshkurter te jete deri ne 6 cm dhe per ate frutgjate te jete deri ne 8 cm.

-Lejohet deri ne 5 % te partise me vyshkje te lehte.Nuk lejohet me semundje e demtues.

-Ngjyra te jete tipike per kultivarin.

-Fruti te jete i bute,me fara te vogla ne fazen e qumeshtit.

-Lejohet me fruta te tejpkura deri ne masen 2% per cilesine e pare.

Domate : Kerkohet domate e cilesise se pare,ku te jene te fresketa,me forme tipike te kultivarit,te plota,te pastra,te pa vrara,te pa shtypura,pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit,te pa prekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe te pa lagura.

-Pjekuria duhet te jete normale,me ngjyre te kuqe,lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit.

-Nuk lejohen domate te tejpkura,te zbutura e te vyshkura.

-Demtime e semundje nuk lejohen.

-Te plasura e te vrara lehtesisht per llojet e mesme e te vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit,por pa rrjedhje lengu.

-Madhesia e kokrres te jete :

-Per te hershmet 3-4 cm

-Per te mesmet e te vonat 7 cm.

Patellxhan : kerkohet cilesia e pare,te jene te fresket,te paster,me siperfaqje te lemuar,me ngjyre te zeze ne manushaqe,me pjekuri normale,me flete jeshile me nuanca te dobeta manushaqe,te pa vyshkura.

-Demtime te ndryshme e semundje nuk lejohen.

-Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm.

-Gjatesia e bishtit te jete jo me shume se 4 cm.

Oepe e thate : Kerkohet cilesia e pare,te jete me pjekuri te plote,me cipe e bisht te thate,te shendosha e te plota,me ngjyre e forme tipike te kultivarit dhe me gjatesi te bishtit deri ne 7 cm.

-Madhesia e kokrres per ovalet te jete nga 4-8 cm dhe per llojet e tjera 5-10 cm.

-Lejohen jo me shume se 1 % e partise me demtime te lehta dhe 1 % lende te huaja.

-Me semundje nuk lejohen.

-Te ngrira,te kalbura e te mykura nuk lejohen.

Speci : Kerkohet cilesia e pare, te jene me forme e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale.

-Lejohen demtime jo me shume se 3 %

-Shija te jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges.

-Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm.

Lakra : Kekrohet cilesia e pare,te jene te zhvilluara,me mbeshtjellje fletesh,e forte ne prekje.Lejohen lakra te pa ngjeshura deri ne 5 % te partise.

-te jene te pastra dhe me 2-3 gjethe te gjelbera,te lidhura me koçanin i cili tejete deri ne 3 cm.

-Lejohen deri ne 5 % e partise me demtime te lehta mekanike,te çara lehtesisht e te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma.

-Me semundje nuk lejohen.

-Pesha e kokrres te jete jo me pak se 1 kg per lakren e hershme dhe per pjekje te mesme e te vona jo me pak se 1.5 kg.

Preshi :Kerkohet cilesia e pare,te jete i fresket,i njome,i paster,me gjyre te bardhe e jeshile,i pa vyshkur dhe i lare me uje te pijshem.

-Diametri ne pjesen me te trasse tejete mbi 2.5-3.5 cm.

-Gjatesia e kercellit te jete 25-45 cm.

-Gjatesia e gjethit nga rozeta te jete jo me shume se 20 cm.

-Sistemi rrenjor te jete jo me shume se 1 cm.

-Demtime e semundje nuk lejohen.

Spinaq : Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne nje kg.

- Me rrenje te prera
- Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm
- Te mos kete prani te barerave te tjera.
- Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 20 cm.
- Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.

Tranguj :Kerkohet cilesia e pare,te jene te njome,te fresket,te paster,te lare me uje te pijshem,me ngjyre jeshile te pa vyshkura .me ere dhe shije karakteristike .

-Diametri mesatar te jete nga 2.5-3 cm.

-Gjatesia te jete nga 20-30 cm

-Demtime mekanike nuk lejohen.

-ambalazhimi ne arka .

Sallata jeshile Kerkohet cilesi e pare, e fresket , e njome, e paster me ngjyre jeshile te celet deri ne te erret, e pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, me gjethe ti lidhur ne rrenje.

Te mos kete demtime mekanike ,me gjethe te pa vrara karakteristike te varietetit.

Karrota . Kerkohet cilesi e pare, e fresket , e njome, e paster me ngjyre petokalli et, e pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, me tufa te lidhura ne rrenje .

gjatesia mesatare 10-15 cm.Ne prerje terthore kompakte e qarte.pa demtime mekanike ose nga semundjet .

Mashurka.Me ngjyre te verdhe ose jeshile ,ne varesi te kultivarit .E lehte ne keputje ,pa fije te forta ,me madhesi 6-10 cm.Te jete e paster ,pa demtime mekanike ,ose nga semundjet .

E ambalazhuar ne arka.

Lloji i mallit : Patate :

-Kerkohet cilesia e pare,te jete e plote,te forta,te pastra e te thata,jo jeshile,jo te mbira me ngjyre dhe me sytha tipike te kultivarit.

-Kokrra te jete e pjekur.

-Madhesia e kokrrs te jete per pataten dimerore mbi 5 cm dhe per ato verore mbi 4 cm.

-Nuk lejohen te gjelbera, te vyshkura, te mbira, te çara e te prera, te kalbura, zgjebe ne plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosa dhe te papastruara nga dherat.

-Duhet te jene te ambalazhuara ne thase rrjete 25 deri ne 30 kg.

Lloji mallit : Fruta (molle, banane)

Molla :Kerkohet cilesia e pare,me forme,ngjyre e shije te kultivarit,pa deformime,me pjekuri teknike te njejte,te shendosha,te pastra,te zhvilluara normalisht,pa ere e shije te huaja.

- Lejohen edhe kokrra pa bisht,por pa difekte rreth bishtit.
- Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi.
- Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy njolla jo te zeza,te vogla,te lehta per kokerr.
- Nuk lejohen te kimbura.
- Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekurenuk lejohen.

-
- Gunga, njolla ne lekure nuk lejohen.
 - Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres lejohet deri ne $\frac{1}{4}$ e siperfaqes se frutit.

Banane : Kerkohet cilesi e pare , te fresketa , me zhvillim normal , ne tufe , me pjekuri teknike te plote :

- Ngjyra te jete jeshile ne te verdhe me ere dhe arome te kendeshme karekteristike e ketij kultivari
- Madhesia e kokrres te jete mesatare.
- Demtime mekanike nuk lejohen
- Njolla te kafeta qe tregojne tejkalimin e pjekurise nuk lejohen
- Gervishtje te lekures nuk lejohen
- Zbutje te lekures nuk lejohen.
- Ambalazhimi te jete ne kuti kartoni standarte tipike per tregetimin e bananes .
- Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise .

Loji i mallit :Gjalpi fresket

-Te jete prodhim vendi me baze qumesht lope vendi , delje ose dhie , i fresket.

-Ngjyra te jete e verdhe karekteristike e gjalpiti te lopes ose e bardhe karekteristike gjalpiti te dhise dhe deles.

-Nuk lejohen perberes te tjere, njolla te erreta karekteristike e gjalpiti jo te fresket.

-Shija te jete e kendshme , pa erera te tjera jo natyrale

-Ambalazhimi te jete me kuti kartoni ne brendesi te mbeshjtelle me leter celofoni standarte 10,20.ose 30 kg.

-Malli te shoqerohet me certifikate te cileses sipas standarteve te miratuara.

-Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit dhe data e skanedces si dhe orgjina e prodhimit te mallit.

Loji i mallit :Djathe i bardhe

-Kerkohet cilesia e pare,vendi , me baze prodhim djathi ne produkt i qumeshtit te lopes, deles, ose dhise.

-Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumesht pluhur ose te kodensuar.

-Djathi te kete kaluar periudhen e stazhionimit mbi 3 muaj

-Ngjyra te jete sipas llojit te qumeshtit , djathe lope, ne ngjyre te qumeshtit (krem), i deles dhe dhise te kete ngjyren kerkteristike te qumeshtit . (i bardhe kur djathi eshte prodhuar me baze qumeshti delje ose dhie , dhe ngjyre kremi kur djathi eshte prodhuar nga qumeshti i lopes)

-Lejohet djathe me perqindje yndyre jo me shume se 3 % .

-Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze karekteristike e djathit te stazhionuar mire.

-Sasia e kripes te jete normale .

-Shija te jete e mire karekteristike e djathit normal pa erera te tjera jo te kendshme .

-Ambalazhimi te jete ne fuci 50 kg , ose 30 kg i shoqeruar me shellire.

-Nuk lejohet me afat skadence me shume se nje vit.

-Malli te jete i shoqeruar me certifikate te cilesise dhe te standarteve te miratuara .

-Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit , data e stazhionit dhe data e skandences.ne etikete te jete shenuar dhe origjina e prodhimit te mallit.

Loji i mallit :Qumesht i fresket

-Kerkohet qumesht lope vendi .

-Qumeshti te jete prodhuar brenda dites mundesisht nga mjelja e pare ne mengjes pasi dhe konsumi do te jete ditor.

-Qumeshti te kete karakteristikat tipike te qumeshtit te lopes i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera , i kulluar dhe i skremuar me perqindje yndyre deri ne 3%.

-Prodhimi te jete i ambalazhuar ne shishe qelqi ose plastike ne sasi 05-1 kg .

-Prodhimi te jete i shoqeruar me certifikate te analizes te bere nga laboratorit veterinar.

-Nuk lejohet qumesht qe ka kaluar mbi tre ore nga mjelja .

-Ne certificate te shonohet dhe origjina e prodhimit te mallit.

Recel

-Te jete prej qershije,kumbulle ose fiku.

- Receli te jete i ambalazhuar ne vazo 1-1.5 kg

- etiketa te pershkruaj saktesisht daten e prodhimit dhe ate te skadimit.

I. Loji i mallit :Veze

- Sipas standartit shteteror 4N/ECE 42 te vitit 2001.

- Vezet te jene prodhim vendi dhe te stampuara ku te dallohet qarte origjina e mallit.

- Te jene te vendosura ne bikurina, te ambalazhuara ne kuti kartoni ku te jete etiketuar prodhuesi, data e prodhimit dhe te jene te vulosura nga prodhuesi mbi cdo kuti.

- Vezet duhet te kene nje afat skadence nga data e prodhimit vetem 15 dite.

- Te jene me peshe 50 deri 70 gr.

II. Loji i mallit :Caj mali

- Te jete i cilesise se pare, i thare mire dhe i ambalazhuar ne pako 1 kg,.

- Kutia e ambalazhit duhet te shprehe qarte te dhenat cilesore e teknike per mallin e kerkuar

Loji i mallit :Oriz

- Treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha, te plota, te pastra e pa myk.Ngjyra e bardhe. Era pa shije te tharte pa ere myku.

- Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri ne 15 %, kokrra te thyera deri ne 12%, lende te huaja deri ne 0.4 %, kokrra te verdha deri ne 4%. Nuk lejohen demtues.

- Ambalazhi ne pako 1kg, letre ose plastmasi.

Loji i mallit :Fasule

- Treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha e te plota.

- Ngjyra e bardhe, shija pa ere myku, lageshtira deri ne 15 %, thyeshmeria deri ne 13 %, lende te huaja deri ne 0.8 %, demtime nga insektet nuk lejohen.

- Ambalazhimi ne thase 20 deri 50 kg.

- Te jete i shoqeruar me certifikate cilesie.

Loji i mallit :Makarona

- Treguesit shqisor: ngjyra e bardhe ne te verdhe, pa shije te hidhur e te tharte, pa ere te huaj.
- Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri ne 13 %, aciditeti jo me shume se 0.16 %, rritja e volumit jo me pak se dy here. Nuk lejohen demtues. Mielli i stazhionuar jo me pak se 15 dite, i situar 100%, nuk lejohen demtues.
- Amballazhimi: ne pako 0.5 ose 1 kg, i etiketuar sipas standartit dhe te futura ne kuti kartoni.

Loji i mallit : Vaj ushqimor

Sipas standart shteteror 203: 2003

- Treguesit fiziko-kimik:
Dendesia relative ne 20 grade.C/ uje 0.918-0.923.

Numri i refraksionit 1.461-1.468.
Numri i sapunifikimit 188-194. Treguesi i jodit 118-141.
- Treguesi i cilesise:
Ngjyra e verdhe ne te lehte.

Era dhe shija karakteristike e vajit te lulediellit, pa ere e shije te huaj.
- Numri i peroksideve: Jo me shume se 10 mek O2 aktiv / kg vaj.
- Numri i aciditetit: jo me shume se 0.4 mg KOH gr vaj.
- Shmangia ne vellim deri ne 1%.
- Kontaminuesit jo me shume se : lende te patretshme 0.05%.
Permbajtja e sapuneve 0.005%.

Lende fluturuese, ne 105 grade c 0.2.
- Amballazhimi dhe etiketimi: Amballazhimi behet ne shishe plastike me kapacitet 1 liter. Mbi cdo amballazh vendoset etiketa per daten e prodhimit, llojin e vajit, masa ne litra, etj. Etiketimi behet sipas legjislacionit ne fuqi.

Loji i mallit :Sheqer

- Treguesit fiziko- kimik
- Sheqer i paster 99.6%, hiri deri 0.07%, lageshtira deri ne 0.16 %.
- Pamja: pluhur i perbere nga kristale te imta e te njellojta.
- Ngjyra: i bardhe ne shkelqim.
- Treguesit shqisor: i derdhur i thate, me shije te embel pa ere te huaj, perdorim te njetrajtshem, te tretet plotesisht.
- Amballazhimi ne pako letre 1 kg dhe etiketuar sipas standartit ne fuqi.

Loji i mallit :Kripe ushqimore

- Te jete e cilesise se pare , e amballazhuar ne pako 0.5 deri 1 kg.
- Pamja: mase e perhedhur dhe e perbere nga kristale te imta e te njellojta.
- Ngjyra: e bardhe me shkelqim.
- Treguesit shqisor: me shije karakteristike te kripur, pa ere te huaj, me perdorim te njetrajtshem, e treteshme plotesisht ne uje.

Loji i mallit :Salce domatesh

- Kerkohet salce domate e perpunuar me baze vetem domate , prodhim vendi ose i huaj.

-
- Malli te jete i amaballazhuar ne kuti lllamarine 400 gr, ose 500 grameshe.
 - Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshjtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen shqipe kur malli eshte i huaj.
 - Permbajtja te jete salce dhe kripe.
 - Perberja e mases te jete homogjene dhe me 18 -20 % lende e thate.
 - Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja.
 - Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle.
 - Shija te jete e embel pa shume aciditet.
 - Aroma te jete e kendeshme ne perputhje me aroren e domates se fresket karakteristike e llojit.
 - Ne etikete te jete shenuar qarte firma prodhuese dhe ajo tregtuese.Kapaku te jete i mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadences.
-
- Nuk lejohet me afat perdorimi me shume se nje vit.

Operatori ekonomik pergatit ushqimin ne menyre te perqendruar ne kuzhine cdo dite ne baze te numrit te shtruarve sipas percaktimeve te dietave te karteles se pacientit.

Ne te gjitha rastet dhe per te gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave behet nga specialisti i Deges se Llogjistikës, cdo dite.

Dega e Llogjistikës, harton pasqyre permbledhese, bazuar ne flete kerkesat ditore sipas racioneve apo dietave.

Pajisjet dhe inventari i imet si per kuzhinen dhe per pavionet do te sigurohen nga kontraktuesi, i cili do te pergjigjet per ruajtjen, mirembajtjen dhe pastrimin e tyre.

Pasqyra permbledhese e pergatitur nga Dega e Llogjistikës, i dorëzohet pergjegjesit te kuzhines se operatorit ekonomik cdo dite brenda ores 13:00, e cila sherben si porosi per dite e nesërme.

Transporti i ushqimit te pergatitur deri te dera e Qendres Spitalore te Burgjeve per vete natyren specifike qe ka objekti, realizohet nga operatori ekonomik me ene te posacme (termuse) te llojeve te ndryshme dhe madhesive te ndryshme ne funksion te sasise qe ofrohet dhe dietave perkatese si dhe per te ruajtur nivelin kulinar te ushqimit dhe temperatures. Pergatitja e pjatave, lugeve dhe tabakave si dhe pastrimi i metejshem eshte detyre e personelit te Autoritetit Kontraktor.

Te gjitha termuset dhe enet qe transportohet ushqimi duhet te jene detyrimisht me material inoxi dhe mbyllje hermetike per te ruajtur produktet nga agjentet atmosferike.

Ushqimet duhet te pergatiten ne racione individuale sipas dietave te percaktuara nga mjeku sipas porosisë se nje dite me pare.

Fondi i mesiperem do te mbuloje kerkesat tona per nje periudhe tre vjecare me nje force ditore prej 100 te semure te denuar ne dite aq sa eshte edhe kapaciteti i shtreterve ne Qendren Spitalore te Burgjeve dhe nr.racionesh per gjithe periudhen 109,500 racione dhe me llojet e dietave bashkangjitur.

Sherbimi do te ofrohet gjate gjithe javes prej dites se hene deri dite e diel sipas vakteve dhe flet-porosisë se Qendres Spitalore te Burgjeve, Tirane si dhe shtesave te racioneve qe mund te jene te nevojshme gjate fundjaves por dhe sipas kerkeses se QSB-se ne rast te shtrimeve te reja dhe te paraportuara ne forcen ditore te cilat do te rakordohen me Sektorin e Logjistikes.

Ushqimet e pergatitura ne racione individuale sipas porosisë, do te dergohen ne vendodhjen e percaktuar ne Qendren Spitalore te Burgjeve si me poshte:

3 here ne dite per pacientët:

- Mengjesi, 07:00-08:00;
- Dreka, 11:30-12.30;
- Darka, 18:00-19:00;

- Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit.
- Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.
- Punonjësit duhe të sillen me edukatë dhe kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit deri në vendodhjen e percaktuar te QSB-se ku behet dorezimi i ushqimit.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu bëhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriat Sanitar Shëndetësor.
- Sigurimi i të gjitha artikujve ushqimore do të jetë sipas kalorive përkatëse të miratuara.
- Llojshmëria e ushqimit do të jetë sipas sezonit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara sipas programit të menisë së përgatitur në baze të dietave dhe kalorive të konfirmuara nga mjeku dietolog.
- Kontraktuesi do të sigurojë ushqim të sigurtë, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.
- Ushqimet do të nënshtrohen kontrollit të analizave, biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit.
- Kontraktuesi duhet të sigurojë ambjente me temperaturën e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve në kuzhinë.
- Kontraktuesi merr përsipër evadimin e mbeturinave të prodhuara gjatë procesit të përgatitjes së ushqimit.
- Ushqimet që janë gati për konsum do të dërgohen në Qendren Spitalore të Burgjeve, në oraret e caktuara, në vendodhjen e percaktuar.
- Përgatitja e pjatave, lugëve e tabakave, si dhe pastrimi i mëtejshëm është detyrë e personelit të Porositesit.
- Produkti ushqimor “mish vici” duhet të jetë i freskët dhe i cilesisë së parë, sipas rekomandimit nr.10181 Prat. date 19.11.2018, "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore.

Numri ditor i pacienteve që konsumojnë llojet e dietave në ditë

Nr.	Emertimi	Dieta Nr.1 (Dieta normale)	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget)	Dieta Nr.5 (Dieta e qullit, 1/2 e lenget)	Dieta NR 7 (Dieta në hepatopatië në fazën akute e subakute)	Dieta Nr. 9 (Dieta për enero-kolite)	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike)	Dieta Nr.14 (Onkologe)	SHUMA E PACIENTEVE NE DITE
1	Numri ditor i pacienteve që konsumojnë llojet e dietave (forca ditore e ushqimit)	84	1	1	1	1	5	7	100

1. Numri i pacienteve të mesipër sipas kapacitetit maksimal të shtrëterve në spital ndahet sipas dietave që kanë qenë me të konsumueshme gjatë 7 vjetëve të fundit, si më poshtë:

Nr.	Forca ditore e ushqimit	Nr. i pacienteve ne dite ose nr.i racioneve ne dite
1	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr.1 (Dieta normale)	84
2	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr.4 (Dieta e lenget)	1
3	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget)	1
4	Pacientë që konsumojnë Dietën N. 7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	1
5	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr. 9 (Dieta per enero-kolite)	1
6	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr.12 (Dieta diabetike)	5
7	Pacientë që konsumojnë Dietën Nr.14 (Onkologe)	7
	SHUMA	100

2. Numri i Forces Ditore të ushqimit të paraqitur me lart shumezuar me numrin e diteve (1095) për të cilën do të lidhet kontrata me Operatorin ekonomik fitues do të japë sasinë e racioneve totale. Sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Lloji i dietave me të përdorshme	Numri i Racioneve ne dite	Numri i diteve	Numri i Raioneve e gjithsej
1	Dieta Nr.1 (Dieta normale) 2 700 k kal (prot100gr, lipide77gr, glucide 420)	84	1095	91,980
2	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget) 2100 k kal (prot 70 gr, lip.95.3gr, gluc.248.6gr)	1	1095	1,095
3	Dieta Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget) 2 100 k kal (prot.80 gr. Yndyrna 12gr. Gluc.297gr.	1	1095	1,095
4	Dieta NR 7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	1	1095	1,095
5	Dieta Nr. 9 (Dieta per enero-kolite) 2000k kal (prot.70gr. lip.63, gluc.308gr	1	1095	1,095
6	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike) Kjo diete varion nga 800-3000k kal, Dieta me diabetiket me diabet të ekuilibruar. (2 300 k kal (prot.88gr. lip.92gr. gluc.278gr)	5	1095	5,475
7	Dieta Nr.14 (Onkologe) Hiperkalorike,hiperproteinike,hiperglucidike e pasur me Ca e Fe 3 000 k kal (prot.122 gr. Yndyrna 108 gr. Gluc. 385gr.)	7	1095	7,665
GJITHSE J		100		109,500

Kërkesa të përgjithshme

- Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara sipas dietave të kwrkuara.

- Ushqimi të gatuhet në ambientet e Sipermarresit. Sipermarresi përgatit ushqimin në mënyrë të përqëndruar në kuzhinën e tij çdo ditë në bazë të numrit të të shtruarve sipas përcaktimeve të dietave të kartelës së pacientit.

Në të gjitha rastet dhe për të gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave bëhet nga specialisti i Degës së Llogjistikës i Autoritetit Kontraktor i cili harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore sipas racioneve apo dietave, çdo ditë.

- Transporti i ushqimit të përgatitur deri te dera e Qendres Spitalore te Burgjeve per vete natyren specifike qe ka objekti, realizohet nga Sipermarresi me ene te posacme (termuse) te llojeve te ndryshme dhe madhesive te ndryshme ne funksion te sasise qe ofrohet dhe dietave perkatese si dhe per te ruajtur nivelin kulinar te ushqimit dhe temperatures. Pergatitja e pjatave, lugeve dhe tabakave si dhe pastrimi i metejshem eshte detyre e personelit te Autoritetit Kontraktor.

- Pajisjet e transportit të ushqimit (enet e posacme, termuse te llojeve te ndryshme sipas dietave ushqimore) do të sigurohen dhe do te mirembahen nga sipërmarrësi për funksionimin sa më normal të tyre, deri në përfundim të kontratës.

- Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë të gjitha orenditë e pajisjet bashkëkohore që nevojiten, për përpunim, gatim, shpërndarje, si dhe pajisjet për ruajtje të zakonshme dhe në kushte frigoriferike.

- Të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas standardeve në fuqi. Automjetet të jene të pajisura me çertifikate higjeno-sanitare të lëshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit të jenë në pronësi ose me qera të vërtetuara me dokumenta.

- Operatori ekonomik të disponojë mjete transporti frigoriferike, për transport të ushqimit të përgatitur. Mjetet dhe pajisjet të jenë të përshtatshme edhe për kushte të vështira të motit.

- Të bëjë shpërndarjen e ushqimit të gatuar sipas orarit të përcaktuar.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontrolle për zbatimin e kushteve të kontratës gjatë të gjitha fazave të procesit (furnizimit të lëndës së parë, përpunimit, gatimit dhe shpërndarjes).

- Sipërmarrësi është përgjegjës për sigurimin e kushteve të higjienës në të gjitha ambientet e gatimit të ushqimit.

- Në zbatim të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 34, pika 9, paragrafi i parë dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12, pika 10, Autoriteti/Enti kontraktor do të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

Magazinimi i lëndës së parë duhet të bëhet në dy forma:

- a. Në temperaturë ambjenti
- b. Në frigorifer ose dhoma frigoriferike

Magazinimi në temperaturë ambjenti bëhet në dollape/rafte metalike të lyera me ngjyrë të qartë në ambiente të destinuara ekskluzivisht për depozitimin e ushqimeve. Këto mjete janë të lashme për të thjeshtuar operacionet e pastrimit të sipërfaqeve.

Këto mjete janë bërë në mënyrë të tillë që të mos lihen volume bosh ose vende që mund të përbëjnë sipërfaqe kolonizimi nga insektet ose mikrobet.

Magazinimi në frigorifer ose dhomë frigoriferike bëhet në temperatura të ndryshme në funksion të produktit që konservohet duke filluar nga temperatura maksimale +5°C deri në -22°C. Të gjithë frigoriferët duhet të kenë një display të jashtëm me treguesit e temperaturës.

Vazhdimësia e energjisë elektrike tek motorët e frigoriferëve duhet të jetë e garantuar me gjeneratorë në pronësi të kompanisë.

Kushtet higjienike të lëndës së parë në fazën e stokimit duhet të jenë nën kontrollin e përgjegjës të magazinës.

O.E. do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit të gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik, është i detyruar të ruajë në rafte të veçanta në mjediset e kuzhinës kampionet e ushqimit të gatuar që do të shpërndahet për 24 orë. Ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

PROGRAMI USHQIMOR

Inventari i imet per pergatitjen e ushqimit

Nr.	Emertimi	Nesia	Sasia minimale
1	Tenxhere e madhe profesionale / bolitore me gaz dhe korent.	Cope	2
2	Boliere	Cope	3
3	Tigan i madh profesional (braziere)	Cope	1
4	Dhoma frigoriferike	Cope	1
5	Frigorifer freskues/ngrires	Cope	2
6	Frulatore	Cope	1
7	Furre profesionale me gaz / me korent	Cope	1
8	Makine grirese mishi	Cope	1
9	Makine grirese zarzavatesh	Cope	1
10	Karrela sherbimi ne kuzhine	Cope	2
11	Karroca transporti ushqimi	Cope	3
12	Karroca termike sherbimi ushqimi (banjomari)	Cope	4
13	Karroca sherbimi per mbledhje tabaka sherbimi	Cope	3
14	Lavamane inox	Cope	3
15	Peshore te ndryshme	Cope	3
16	Qeruese patatesh	Cope	1
17	Shtrydhese frutash	Cope	1

18	Sobe me vatra gaz /korent	Cope	1
19	Trung mishi	Cope	1
20	Tavolina pune inox	Cope	4
21	Tenxhere inoxi me mbyllje hermetike per transportin e ushqimit te gatuar	Cope	7

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia minimale
1	Gota uji	Cope	200
2	Kana / broke uji	Cope	20
3	Kupa	Cope	200
4	Kuti polisteroli	Cope	10
5	Luge inox tavoline	Cope	200
6	Pirunj inox tavoline	Cope	200
7	Pjata	Cope	400
8	Tabaka vetsherbimi	Cope	200
9	Tasa	Cope	200
10	Tava inox	Cope	25
11	Thika inox tavoline	Cope	200

Shtojca 5.

**LOTI 2 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”,
PËR AKADEMIN E SIGURISË**

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike:

Ne kete racion ushqimore kemi te perfshira te gjithë artikujt ushqimor sipas “Normes Ushqimore per student dhe kursante ne Shkollat e Policise, dhe qe trajtohen ne institucionet e tjera te Policis Shtetit” Pasqyra Nr.3, te miratuara me Urdhzim te perbashket te Minitrit Brendshem nr.942, date 03.10.2017, dhe Ministrit Shendetesis nr.4130, datë 09.10.2017 “Per miratimin e normave të trajtimit me ushqim te Punonjësve të Policisë Shtetit , të Studentë ve dhe të Kursantë ve në Institucionet Arsimore të Policisë së Shtetit si dhe të Shtetasve të ndaluar të Arrestuar deri në sqarimin e pozitë s së tyre”, konkretisht:

Pasqyra nr.3 :

Nr.	Artikulli	Nj/matese	Sasia /gr	Energjia k/Cal	Proteinat/gr	Yndyrnat /gr	Glucidet/gr
1	Buke gruri masive	gr	450	1102.5	45.45	10.35	220.95
2	Oriz	gr	60	217.2	4.2	0.36	52.56
3	Makarona	gr	60	213.6	6.48	0.18	49.68
4	Fasule	gr	50	155.5	11.8	1.25	25.85
5	Mish	gr	200	288	40.6	14	0
6	Vaj ushqimor	gr	40	360	0	40	0
7	Gjalp	gr	30	227.4	0.24	25.02	0.33
8	Sheqer	gr	40	156.8	0	0	41.8
9	Sallam	gr	50	227	13.7	19.15	0
10	Djath I bardh	gr	100	250	15.6	20.2	1.5
11	Qumesht I fresket	gr	400	196	14	7.2	20
12	Veze (kokrr)	gr	120	187.2	15.6	13.32	1.2
13	Patate	gr	200	170	4.2	2	3.6
14	Perime per gatim + sallat	gr	450	85.5	8.1	1.8	9.9
15	Fruta te fresketa	gr	400	180	0.8	1.2	44
16	Recel	gr	30	62.7	0.18	0	16.56
17	Salc per gjell	gr	6	3	0.054	0.024	0.684
18	Caj	gr	3	3.24	0.588	0.06	0.09
19	Krip	gr	5	0	0	0	0
20	Ereza	gr	3	1.98	0.066	0.06	0.291
21	Miell tip 00	gr	15	51.45	1.65	0.105	11.7
	Totali			4139.07	183.308	156.279	500.695

Pasqyra nr.13.

Ekuivalentet ushqimore sipas nengrupeve te ushqimore me origjine te njejte

Nr	Grupi Ushqimeve	E kuivalentet Ushqimore
1	Qumesht dhe nenproduktet e tij	
	125 gr qumesht =	125 gr kos
		100 gr djath I bardhe
		50 gr djath kackavall
2	Mish peshk dhe veze	
	100 gr mish vici/derri/lope etj =	100 gr mish te bardhe (pule , gjel , leपुरi)
		50 gr sallam/proshute
		50 gr peshk /fruta deti (te fresketa ose te ngrira)
		50 gr konserva peshku
		50 gr veze
3	Bishtajore	
	150 gr bishtajore te fresketa (mashurka , bishtaja) =	50 gr fasule e thate
		50 gr thjerreza
4	Dritherat dhe nenproduktet e tij	
	50 gr buke =	80 gr oriz
		80 gr makarona
		80 gr miser
		50 gr kroasan/kek etj
		30 gr drithera per mengjes cornflax/musli
		200 gr patate
5	Frutat	
	150 gr fruta te fresketa =	30 gr fruta te thata (arra , bajame , kikirike) etj.
		30 gr fruta te thata te sheqerosura
6	Yndyrnat	
	10 ml vaj ulliri ose farerash (misri , luledielli) =	10 gr gjalp

Pasqyra nr.14

"Lista e ushqimeve te normes e shprehur ne pjesë të ngrënshme, produkt i plotë

Nr.	Artikulli	Nj/m	Norma	Koeficinti ushqimor per pjese te ngrënshme ushqimi/100 gr e shprehur ne %	Sasia /gr pjese e plote e ushqimit
1	Buke gruri masive	gr	450	100	450
2	Oriz	gr	60	100	60
3	Makarona	gr	60	100	60
4	Fasule	gr	50	100	50
5	Mish	gr	200	60	280
6	Vaj ushqimor	gr	40	100	40
7	Gjalp	gr	30	100	30
8	Sheqer	gr	40	100	40

9	Sallam	gr	50	100	50
10	Djath I bardh	gr	100	100	100
11	Qumesht I fresket	gr	400	100	400
12	Veze (kokrr)	gr	120	100	120
13	Patate	gr	200	83	234
14	Perime per gatim + sallat	gr	450	85	517.5
15	Fruta te fresketa	gr	400	78	488
16	Recel	gr	30	100	30
17	Salc per gjell	gr	6	100	6
18	Caj	gr	3	100	3
19	Krip	gr	5	100	5
20	Ereza	gr	3	100	3
21	Miell tip 00	gr	15	100	15

Pasqyra nr.15

“Lista e perimeve te normave e shprehur si pjesë e ngrëshme product i plotë :

Nr.	Perime	Koeficienti ushqimor per pjeset te ngrëshme
1	Patllixhane	92
2	Karrota	95
3	Qepa	83
4	Speci	82
5	Domate	100
6	Spinaq	83
7	Presh	77
8	Lakra	94
9	Lulelaker	66
10	Brokoli	77
11	Kastravec	77
12	Molla	85
13	Portokalle	80
14	Pjeshka	91
15	Kajsi	94
16	Shalqi	52
17	Pjeper	47
18	Rrush	94
19	Dardhe	84

➤ Lista e artikujve ushqimore te ndarë sipas vafteve

Per vaftin mengjes do te gatuhet e shperndahet artikujt:

Nr.	Artikulli	Nj/m	Sasia/Mengjes
-----	-----------	------	---------------

1	Buke gruri masive	gr	150
2	Oriz	gr	0
3	Makarona	gr	0
4	Fasule	gr	0
5	Mish	gr	0
6	Vaj ushqimor	gr	0
7	Gjalp	gr	30
8	Sheqer	gr	25
9	Sallam	gr	0
10	Djath I bardh	gr	75
11	Qumesht I fresket	gr	0
12	Veze 1 (kokrra)	gr	60
13	Patate	gr	0
14	Perime per gatim + sallat	gr	0
15	Fruta te fresketa	gr	0
16	Recel	gr	30
17	Salc per gjell	gr	0
18	Caj Mali	gr	3
19	Krip	gr	0
20	Ereza	gr	0
21	Miell tip 00	gr	0

Per vaftin Dreke do te gatuhen e shperndahen artikujt:

Nr.	Artikulli	Nj/m	Sasia/ Dreke
1	Buk Gruri Masive	gr	150
2	Oriz	gr	0
3	Makarona	gr	60
4	Fasule	gr	0
5	Mish	gr	280
6	Vaj ushqimor	gr	25
9	Sallam	gr	0
13	Patate	gr	234
14	Perime per gatim + sallat	gr	466
15	Fruta te fresketa	gr	488
16	Recel	gr	0
17	Salc domate	gr	4
18	Caj	gr	0
19	Krip	gr	2
20	Ereza	gr	3
21	Miell tip 00	gr	15
22	Veze	gr	60
23	Qumesht	m/l	100
24	Djathe	gr	25
25	Sheqer	gr	15

Per vaftin Darkë do të gatuhen e shperndahen artikujt

Nr.	Artikulli	Nj/m	Sasia Darke
1	Buke gruri masive	gr	150
2	Oriz	gr	60
3	Makarona	gr	0
4	Fasule	gr	50
5	Mish	gr	0
6	Vaj ushqimor	gr	15
7	Gjalp	gr	0
8	Sheqer	gr	0
9	Sallam	gr	50
10	Djath I bardh	gr	0
11	Qumesht I fresket	gr	300
12	Veze (kokrr)	gr	0
13	Patate	gr	0
14	Perime per gatim + sallat	gr	0
15	Fruta te fresketa	gr	0
16	Recel	gr	0
17	Salc domate	gr	2
18	Caj	gr	0
19	Krip	gr	3
20	Perime	gr	51.5
21	Miell tip 00	gr	0

➤ **Specifikimet teknike te lendeve te para qe do te perdoren per gatim dhe ushqim**

I Lloji i mallit : Buke gruri rreze 75

Specifikimet teknike :

1. Buka e grurit do te prodhohet me miell rreze 75 %, i stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete i fresket, me ngjyre, ere, shijedhe lageshtire konforme standarteve perkatese te miellit me rreze 75 %. Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj.
2. Buka duhe te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjaftueshem. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet te jete konforme standartit teknik te prodhimit te saj.
3. Korja e bukes duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte, ne te gjithë siperfaqen.
4. Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithë vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura.
5. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku.

Treguesit fiziko -kimik:

6. Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe l(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72 %, aciditeti jo me shume se 45%.
7. Furnizimi i bukes do te behet jo me pak se 4 ore pas pjekjes. Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster dhe te siguroje mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

-
8. Autoriteti Kontraktore (sektori ekonomik) ka te drejte te kerkoje shoqerimin e bukes me : certifikate cilesie, sa here qe e shikon te nevojshme, por jo me shume se nje here ne tre muaj.
9. Buka duhet te jete e prere ne feta dhe e ambalazhuar .

II. Lloji i mallit : Perime (bamje, bizezele bishtajore, domate, patellxhan, qepe e njome, qepe e thate, specia, laker, presh, spinaq).

Specifikimet teknike:

1.Bamje :Kerkohen te jene te fresketa, te shendosha, te pastra, me fiye normale per kultivarin dhe fara qe duket lehte, me forme te drejte, lehtesisht te deformuar. Forma te jete e nje prizmi shumekendesh qe ngushtohet ne maje, te pa drunjezuara e pa fiye. Gjatesia e cilesise se pare per bamjen frutshkurter te jete deri ne 6 cm dhe per ate frutgjate te jete deri ne 8 cm.

-Lejohet deri ne 5 % te partise me vyshkje te lehte.Nuk lejohet me semundje e demtues.

-Ngjyra te jete tipike per kultivarin. -Fruti te jete i bute, me tara te vogla ne fazen e qumeshtit. -Lejohet me fruta te tejpkjura deri ne masen 2% per cilesine e pare.

2.Domate : Kerkohet domate cilesise se pare, ku te jene te fresketa, me forme tipike te kultivarit, te plota, te pastra, te pa vrara, te pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, te pa prekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe te pa lagura.

-Pjekuria duhet te jete normale, me ngjyre te kuqe, lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate te tejpkjura, te zbutura e te vyshkura. Demtime e semundje nuk lejohen. Te plasura e te vrara lehtesisht per llojet e mesme e te vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lengu. -Madhesia e kokrres te jete: -Per te hershmet 3-4 cm -Per te mesmet e te vonat 7 cm.

3. Patellxhan : kerkohet cilesia e pare, te jene te fresket, te paster, me siperfaqje te lemuar, me ngjyre te zeze ne manushaqe, me pjekuri normale, me flete jeshile me nuanca te dobeta manushaqe, te pa vyshkura. Demtime te ndryshme e semundje nuk lejohen. Per te gjatet, kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm. Gjatesia e bishtit te jete jo me shume se 4 cm.

4.Qepe e njome

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jene te njoma, te fresketa, te pastra, te lara me uje te pijshem, me ngjyre jeshile te gjetheve, e pa cara,te pa vyshkura e pa karabush.

-Diametri i kercellit te jete mbi 1.5 cm. -Gjatesia e tufes te jete pa kufizim dhe me bishta te pa prera. -Sistemi rrenjor te jete deli ne 1 cm. Demtime mekanike nuk lejohen. Gjethe te verdha e te lagura, karabushe te medhenj, te gjate e te kalbur nuk lejohen.

5. Qepe e thate

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jete me pjekuri te plote, me cipe e bisht te thate, te shendosha e te plota, me ngjyre e forme tipike te kultivarit dhe me gjatesi te bishtit deri ne 7 cm. Madhesia e kokrres per ovalet te jete nga 48 mm dhe per llojet e tjera 50-100 mm. Lejohen jo me shume se 1 % e partise me demtime te lehta dhe 1 % lende te huaja. Me semundje nuk lejohen. Te ngrira,te kalbura e te mykura nuk lejohen.

6. Speci

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jene me forine e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen demtime jo me shume se 3 %. Shija te jete karakteristike e

kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges. Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm.

7.Lakra

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jene te zhvilluara, me mbeshtjellje fletesh, e forte ne prekje. Lejohen lakra te pa ngjeshura deri ne 5 % te partise. Te jene te pastra dhe me 2-3 gjethe te gjelbera, te lidhura me kocanin i cili tejete deri ne 3 cm. Lejohen deri ne 5 % e partise me demtime te lehta mekanike,te cara lehtesisht e te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma. Me semundje nuk lejohen. Pesha e kokrres te jete jo me pak se 1 kg per lakren e hershme dhe per pjekje te mesme e te vona jo me pak se 1.5 kg.

8.Preshi

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jete i fresket,i njome,i paster,me gjyre te bardhe e jeshile,i pa vyshkur dhe i lare me uje te pijshem. Diametri ne pjesen me te trashe te jete mbi 2.5-3.5 cm. Gjatesia e kercellit te jete 25-45 cm. Gjatesia e gjethit nga rozeta te jete jo me shume se 20 cm. Sistemi rrenjor te jete jo me shume se 1 cm. Demtime e semundje nuk lejohen.

9.Spinaqi

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne 1-nje kg. Me rrenje te prera. Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm. Te mos kete prani te barerave te tjera. Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 20 cm.Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.

10. Lloji i mallit : Patate

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, te jete e plote, te forta, te pastra e te thata, jo jeshile, jo te mbira me ngjyre dhe me sytha tipike te kultivarit. -Kokrra te jete e pjekur.-Madhesia e kokrres te jete per pataten dimerore mbi 5 cm dhe per ato verore mbi 4 cm. -Nuk lejohen te gjelbera, te vyshkura, te mbira, te cara e te prera, te kalbura, zgjebe ne plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosa dhe te papastruara nga dherat. -Duhet te jene te amballazuara ne thase rrjete 25 deri ne 30 kg.

III. Lloji mallit: FRUTA (dardhe ,molle, rrush, pjeshke, portokalle, banane)

Specifikimet teknike :

1.Dardha

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, me zhvillim normal, te shendosha, me ngjyre karakteristike te kultivarit ,me pjekuri teknike dhe me bisht. Madhesia e kokrres ne mm te jete jo me pak se 45 per dardhat e rrumbullakta dhe 40 mm per ato te gjata. Demtime mekanike lejohen deri ne 5 % te partise se mallit. Malli nuk lejohet të jene me semundje. demtime nga bryma, ngrica, të lagura dhe lëndë të tjera të huaja.

2.Molla

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije te kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra ,te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa difekte rreth bishtit. -Madhesia e kokrres te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi. -Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy

njolla jo te zeza, te vogla, te lehta per kokerr. Nuk lejohen te krimbura. Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekure nuk lejohen. Gunga, njolla ne lekure nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres lejohet deri ne 1/4 e siperfaqes se frutit.

3.Rrushi

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare,veshuli me dendesi tipike te kultivarit. Lejohen veshul te vegjel qe permbajne jo me pak se 10 kokrra, por te mos kalojne 5 % te partise. Kokrrat te jene te fresketa me zhvillim normal, pjekuri te plote, me cilesi te shendoshe e te paster. Nuk lejohen demtime mekanike dhe kokrra te skuqura. Permbajtja e sheqerit te jete sipas llojit te varietetit. -Nuk lejohen lende te huaja.-Nuk lejohen kokrra te mykura e te kalbura, te fermentuara dhe te thara.

4.Pjeshka

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare, kokrra te jete e fresket, me zhvillim normal, me ngjyre karakteristike te kultivarit, te pasterta, pa bishta, me shije te embel dhe ere karakteristike te kultivarit. Te jete me pjekuri te plote teknike. Madhesia e kokrres te jete per te hershmet deri ne 50 mm, gjysem te hershme deri ne 55 mm dhe te vonshme deri ne 60 mm. Demtime te lehta mekanike nuk lejohen. Demtime nga semundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre te jete jo me shume se 5 %. Te mykura, te fermentuara, te kalbura dhe lende te huaja nuk lejohen.

5.Portokalli

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare, i fresket, me zhvillim normal, te shendoshe e me bisht. Pra dhe mbas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, perkatesisht 5 & 20 %, me pjekuri teknike te plote. Ngjyra te jete karakteristike e kultivarit, e verdhe ne portokalli, me ere karakteristike dhe shije te embel ne te athet, pa shije te hidhur. Madhesia e kokrres te jete jo me pak se 70 mm. Demtime mekanike nuk lejohen. Te prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Lende te huaja nuk lejohen. Gervishje ne siperfaqe por pa prekur tulin, nuk lejohen. Zbutje te kokrrave, ngrirje dhe lagie te siperfaqes se tyre nuk lejohen.

1. Banane

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare, te fresketa , me zhvillim normal, ne tufe , me pjekuri teknike te plote . Ngjyra te jete jeshile ne te verdhe me ere dhe arome te kendeshme karakteristike e ketij kultivari. Madhesia e kokrres te jete mesatare. Demtime mekanike nuk lejohen. Njolla te kafeta qe tregojne tejkalinim e pjekurise nuk lejohen. Gervishtje te lekures nuk lejohen. Zbutje te lekures nuk lejohen. Ambalazhimi te jete ne kuti kartoni standarte tipike per tregetin e bananes. Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise.

IV. Loji i mallit bulmet:

1. Gjalp i fresket

Specifikimet teknike :

Te jete prodhim vendi me baze qumesht lope vendi, delje ose dhie , i fresket. Ngjyra te jete e verdhe karakteristike e gjalpit te lopes ose e bardhe karakteristike gjalpit te dhise dhe deles. Nuk lejohen perberes te tjere, njolla te erreta karakteristike e gjalpit jo te fresket. Shija te jete e kendeshme, pa erera te tjera jo natyrale. Ambalazhimi te jete me kuti kartoni

ne brendesi te mbeshtjelle me leter celofoni standarte 10,20 ose 30 kg. Malli te shoqerohet me certifikate te cileses sipas standarteve te miratuara. Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit dhe data e skadences si dhe origjina e prodhimit te mallit.

2. Djathë i bardhë

Specifikimet teknike:

Kerkohet cilesia e pare, vendi, me baze prodhim djathi neprodukt i qumeshtit te lopes, deles, ose dhise. Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumesht pluhur ose te kodensuar. Djathi te kete kaluar periudhen e stazhionimit mbi 3 muaj. Ngjyra te jete sipas llojit te qumeshtit , djathe lope, ne ngjyre te qumeshtit (krem), i deles dhe dhise te kete ngjyren kerkeristike te qumeshtit. (i bardhe kur djathi eshte prodhuar me baze qumeshti delje ose dhie , dhe ngjyre kremi kur djathi eshte prodhuar nga qumeshti i lopes). Lejohet djathe me perqindje yndyre jo me shume se 3 %. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze karekeristike e djathit te stazhionuar mire. Sasia e kripes te jete normale . Shija te jete e mire karekeristike e djathit normal pa erera te tjera jo te kendshme . Ambalazhimi te jete ne fuci 50 kg, ose 30 kg i shoqeruar me shellire. Nuk lejohet me afat skadence me shume se nje vite. Malli te jete i shoqeruar me certifikate te cilesise dhe te standarteve te miratuara. Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, data e stazhionit dhe data e skadences. Ne etikete te jete shenuar dhe origjina e prodhimit te mallit.

3. Qumesht i fresket

Specifikimet teknike :

Kerkohet qumesht lope vendi. Qumeshti te jete prodhuar brenda dites mundesisht nga mjelja e pare ne mengjes pasi dhe konsumi do te jete ditor. Qumeshti te kete karekeristikat tipike te qumeshtit te lopes i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera , i kulluar dhe i skremuar me perqindje yndyre deri ne 3%. Prodhimi te jete i ambalazhuar ne shishe qelqi ose plastike ne sasi 05-1 kg. Prodhimi te jete i shoqeruar me certifikate te analizes te bere nga laboratory veterinar. Nuk lejohet qumesht qe ka kaluar mbi tre ore nga mjelja . Ne certificate te shonohet dhe origjina e prodhimit te mallit.

1. Recel

Specifikimet teknike

Te jete prej qershije, kumbulle ose fiku. Receli te jete i ambalazhuar ne vazo 1-1.5 kg etiketa te pershkruaj saktesisht daten e prodhimit dhe ate te skadimit.

V. Lloji i mallit mish sallam

1. Mish vici i fresket

Specifikimet teknike :

Kerkohet mish gjedhi ne rritje (vici) qe te plotesoje kerkesat e standartit shteteror Nr.1441, te vitit 1987. Raca e tyre te jete e I ndryshme. Kerkohet cilesia e pare sipas standartit dhe vetem **kofshet e pasme**.

Pamja e jashtme : Siperfaqja e jashtme te jete e mbuluar me nje cipe te holle tharje. Siperfaqja e mishit te ftohur menjehere pas prerjes te jete i tejdukshem. Tendinat te jene te ndritshme, elastike dhe te forta.

Ngjyra: Mishi te jete me ngjyre roze dhe i dhjamit te jete me ngjyre te bardhe. *Konsistenca*: Te jete e bute dhe elastike. Ne prerje te duket kompakt.

Era: Te jete e kendshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave : Te mbushi te gjithë kanalën e palces, ngjyra te jete roze ne te verdhe. Cdo kofshe, damkosen me vulen e kontrollorit veterinar e sanitar dhe me

vulen e llojit e te cilesise se mishit. Cdo parti mishi shoqerohet me certifikaten veterinare me te cilen vertetohet gjendja e tij e mire shendetsore per shitje ne treg (konsum).

1. Sallam

Specifikimet teknike :

Te jene te prodhuara nga firma prodhuese vendase, te certifikuara, te jene te shoqeruara me etiketen e prodhuesit. Te jene me mish vici ose derri me ngjyre roze e celur, fundet te jene te lidhura mire, pamja e brendshme ne prerje terthore te paraqes nje mase perzjerje te njetrajteshme, pa boshlleqe ajri, me ngjyre natyrore te mishit te kuqe roze pa njolla te errta. Mishi dhe dhjami te jene te shpemdara njelloje ne te gjithe siperfaqen. Qendrushmeria elastike dhe gjate shtypjes te mos ngelet shenja. Era e kendeshme karakteristike per erezat e perdorura, yndyrnat jo me shume se 23 % dhe kripa jo me shume se 2 -3 %. Ngarkesa mikrobike te jete brenda normave te lejuara nga Instituti i Shendetit Publik. Te jene amballazhuar ne kuti kartoni 5 kg.

VI. Loji i mallit: kolonjale

1. Oriz

Specifikimet teknike :

Treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha, te plota, te pastra e pa myk. Ngjyra e bardhe. Era pa shije te tharte pa ere myku.

Treguesit fiziko kimik: lageshtira deri ne 15 %, kokrra te thyera deri ne 12%, lende te huaja deri ne 0.4 %, kokrra te verdha deri ne 4%. Nuk lejohen demtues. Amballazhi ne pako 1kg, letre ose plastmasi.

2. Fasule

Specifikimet teknike :

Treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha e te plota. Ngjyra e bardhe, shija pa ere myku, lageshtira deri ne 15 %, thyeshmeria deri ne 13 %, lende te huaja deri ne 0.8 %, demtime nga insektet nuk lejohen. *Amballazhimi:* ne thase 20 deri 50 kg. Te jete i shoqeruar me certifikate cilesie.

3. Makarona

Specifikimet teknike :

Treguesit shqisor: ngjyra e bardhe ne te verdhe, pa shije te hidhur e te tharte, pa ere te huaj. Treguesit fiziko -kimik: lageshtira den ne 13 %, aciditeti jo me shume se 0.16 %, rritja e volumit jo me pak se dy here. Nuk lejohen demtues. Mielli i stazhionuar jo me pak se 15 dite, i situar 100%, nuk lejohen demtues. Amballazhimi: ne pako 0.5 ose 1 kg, i etiketuar sipas standartit dhe te futura ne kuti kartoni.

4. Vaj ushqimor

Specifikimet teknike :

Sipas standart shteteror 203: 2003. Treguesit fiziko-kimik: Dendesia relative ne 20 grade.Cj uje ne 20 grde.C 0.918-0.923. Numri i refraksionit 1.461-1.468. Numri i sapunifikimit 188-194. Treguesi i jodit 118-141. Treguesi i cilesise: Ngjyra e verdhe ne te lehte. Era dhe shija karakteristik e vajit te lulediellit, pa ere e shije te huaj. Numri i peroksideve: Jo me shume se 10 mek 02 aktiv / kg vaj. Numri i aciditetit: jo me shume se 0.4 mg KOH gr vaj. Shmangia ne vellim deri ne 1 %. Kontaminuesitjo me shume se: lende te patretshme 0.05%. Permbajtja e sapuneve 0.005%. Lende fluturuese, ne 105 grade c 0.2. Amballazhimi dhe etiketimi: Amballazhimi behet ne shishe plastike me kapacitet 1 liter. Mbi cdo amballazh vendoset etiketa per daten e prodhimit, llojin e vajit, masa ne litra, etj. Etiketimi behet sipas legjislacionit ne fuqi.

5. Sheqer

Specifikimet teknike :

Treguesit fiziko- kimik: Sheqer i paster 99.6%, hili deli 0.07%, lageshtira deli ne 0.16 %. Pamja: pluhur i perbere nga kristale te imta e te njellojta. Ngjyra: i bardhe ne shkelqim. Treguesit shqisor: i derdhur i thate, me shije te embel pa ere te huaj, perdorim te njetrajtshem, te tretet plotesisht. Amballazhimi ne pako letre 1 kg dhe etiketuar sipas standartit ne fuqi.

6. Kripe ushqimore

Specifikimet teknike :

Te jete e cilesise se pare, e amballazhuar ne pako 0.5 deli 1 kg. Pamja: mase e perhedhur dhe e perbere nga kristale te imta e te njellojta. Ngjyra: e bardhe me shkelqim. Treguesit shqisor: me shije karakteristike te kripur, pa ere te huaj, me perdorim te njetrajtshem, e treteshme plotesisht ne uje.

7. Salce domatesh

Specifikimet teknike :

Kerkohet salce domate e perpunuar me baze vetem domate, prodhim vendi ose I huaj. Malli te jete i amballazhuar ne kuti llamarine 400 gr, ose 500 gramshe. Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen shqipe kur malli eshte i huaj. Permbajtja te jete salce dhe kripe. Perberja e mases te jete homogjene dhe me 18 -20 % lende e thate. Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja. Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle. -Shija te jete e embel pa shume aciditet.

I Kërkesa të përgjithshme

1. Operatori ekonomik te jete i regjistruar ne regjistrin tregtar si person juridik, "operator i biznesit ushqimor".
2. Artikujt ushqimore qe do te perdoren per gatim ushqimi, duhet te plotesojne specifikimet teknike te lendeve te para,
3. Operatori ekonomik eshte i detyruar te zbatoje procedurat e manaxhimit te ushqimit te kerkuara ne urdhrin e Titullarit te Autoritet Kontraktor.
4. Operatori ekonomik duhet te kete inventarin e nevojshem per ruajtjen, perpunimin, gatimin, dhe shperndarjen e ushqimit per nje efektiv afersisht prej 500 veta ne cdo vakt sipas orareve te percaktuara ne kete material (dokument), referuar dhe Pasyra 16 "Normat e pajisjeve dhe materialeve te sherbimit te ushqimit per kuzhinen e menden ne Institucionet e Policise Shtetit" Udhezimi i Perbashket i Ministrit Brendshem nr.942 date 3.10.2017 dhe Ministrit Shendetesis 4130 dt 5.10.2017.
5. Operatori ekonomik te siguroje e disponoje ne guzhine (**guzhina e Akademise Sigurise**) e ambjente shërbimi, mjete matese te sasise, te cilat të jenë të certifikuara nga Drejtoria e Meteorologjisë (Inspektorati i kalibrimit te mjeteve matëse).
6. Operatori ekonomik, duhet të siguroje furnizimin **me energji elektrike dhe uje te pijshem, gaz**, duke nenshkruar **kontratat** me operoret ekonomike si OSHEE, Ujesjellesin, dhe operore privat për gaz, gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion burime alternative furnizimi.
7. Cdo dite perfaqesues te operatorit ekonomik do te rakordojnë me personin e ngarkuar nga titullari i Akademisë për përcaktimin e numrit të racioneve ditore të ushqimit (mëngjes,

drekë, darkë) që do të përgatiten për konsumim në AS. Për çdo vaft shërbimi ushqimor të dokumentohet me dalje provizore.

8. Operatori ekonomik, nuk mund të transferojë e kalojë detyrimet e tij kontraktuale një pale të tretë, pa pelqimin e Autoritet Kontraktor.

9. Operatori ekonomik do të paraqesë në fund të çdo muaji faturën dhe dokumentacionin justifikues për shërbimin e ofruar.

II Kërkesa teknike për përgatitjen e ushqimit dhe Sigurine Ushqimore

1. Ushqimi të gatuhet në Akademinë e Sigurisë.

2. Të gjithë artikujt ushqimor që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së parë, të sigurojnë gjithë vlerat ushqyese që parashikon legjislacioni në fuqi.

3. Ushqimi për çdo vakt duhet;

- të jetë i gatuar në cast,
- racioni ditor duhet të përmbajë sasinë e kërkuar të artikujve dhe kalorive sipas tabelave të përcaktuara në këtë material (dokument), të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas liste menus javore dhe ditore,
- të serviret i ngrohte sipas orareve të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë .
- Në raste të situatave të emergjencës, për shkak të shërbimeve të ndryshme, koha dhe mënyra e shërbimit duhet të përcaktohet në marrëveshje midis operatorit ekonomik dhe palës kontraktuese.

4. Në asnjë rast nuk do të lejohet, zëvendësimi i artikujve ushqimorë që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive natyrore apo të fuqisë madhore.

5. Operatori ekonomik, do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të kampjoneve të ushqimit të gatuar sipas kërkesave të VKM, si dhe sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

6. Personeli që do të realizojë procesin e prodhimit të ushqimit, të ketë kualifikimin e nevojshëm profesional, uniformën e pastër me logon e operatorit si dhe të jetë pajisur me librezë shëndetësore.

7 . Operatori ekonomik fitues, të marrë në konsideratë dhe furnizimin me ushqim të punonjësve të policisë në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë të Brendshme me vendndodhje Durrës në periudha të ndryshme kohore dhe në strukturat e tjera policore ku zhvillohen trajnime e aktivitete të ndryshme studimore.

III Programi ushqimor dhe shërbimi i ushqimit

Programi Ushqimor

1. Programi ushqimor do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kalorinë e duhura.

2. Llojshmëria e ushqimit, sasia e cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi i Menuja Javore e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë në Akademinë e Sigurisë në bazë të normave.

3. Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e operatorit ekonomik. Operatori ekonomik do të zbatojë planin e menuse ditore dhe javore të ushqimit sipas programit të miratuar nga Akademia.

Servirja e ushqimit

1. Materialet që do të përdoren për gatim shpërndarje dhe servirje të ushqimit të jenë prej inoksi, porcelani dhe qelqi.

2. Servirja e ushqimit do të bëhet në mensa në formën e vetëshërbimit, duke u shpërndarë nga banakë inoksi me sistem ngrohje me ujë, me qëllim që ushqimi të shpërndahet gjithmonë i ngrohtë.

3. Të realizohet vendosja e pajisjeve bashkëkohore në kuzhinë dhe mensa menjëherë me lidhjen e kontratës. Pajisjet e nevojshme që i shërbejnë procesit të konsumimit të ushqimit, , komplet servirje inoksi për çdo tavolinë për 4 veta (me vaj, uthull, kripe, erezë, kruajtësë dhembesh, gota uji dhe kane qelqi, kartopçeta).

Në përfundim të konsumimit të ushqimit përdoruesit duhet, të vendosin në karroca të posaçme, të shpërndara në sallë, tabakat me pjatat e palara duke lënë tavolinat e pastra për ata që do të vinë më pas.

Ilustrime fotografike



IV. Kërkesat higjeno-sanitare.

1. Operatori ekonomik duhet të sigurojë kushte higjienike të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të guzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe në mensa, duke bërë dhe lëyerjen e tyre , minimalisht 2 herë në ditë.

2. Operatori ekonomik, do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit, për në vendet e caktuara nga bashkia, si vend grumbullimi mbeturinash.

3. Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjenes për larjen, pastrimin, dhe përpunimin e zarzavateve dhe frutave, sipas kërkesave të ligjeve në fuqi në fushën e higjenes dhe ushqimit.

4. Operatori ekonomik për qëllime higjienë dhe pastrimi të përdorë detergjente dhe solucione kimike të certifikuar nga institucionet e njohura me ligj dhe të pa demshme për shëndetin e njerëzve.

- Të vendosë në ambientet e muncës, aparate të filtrimit të ujit si dhe gota, në mënyrë që personat që trajtohen me ushqim të marrin e konsumojnë sasinë e nevojshme të ujit.
- Të sigurojë rezervuar për ujë të pijshëm, me kapacitet deri në 5000 litra dhe në rastet e ndërprerjes së furnizimit me ujë nga rrjeti duhet të sigurojë atë vetë dhe me mjetet e tij
- Ambientet **kuzhina dhe mensat**, për funksionimin sa më normal të tyre do të mirëmbahen nga sipërmarrësi, deri në përfundim të kontratës.
- Kontraktuesi duhet të marrë masa vete, për riparimet e difekteve të ndryshme që ndodhin në objektet që përdor.
- Këto ambiente, do të plotësojnë normat higjieno-sanitare, kushtet teknike nga ana ndërtimore, si dhe impiantet elektrike, hidraulike dhe shkarkimet e ujërave të cilat do të vihen në funksionim për përdorim nga operatori ekonomik brenda normave teknike dhe afatit të përcaktuar si më sipër.
- Ambientet do të mirëmbahen nga sipërmarrësi deri në përfundimin e afatit të kontratës. Pajisjet dhe makineritë që do të shërbejnë për gatim dhe shpërndarjen e ushqimit, me përfundimin e kontratës do të terhiqen nga operatori ekonomik.

5. Operatori ekonomik të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të lëndëve të para ushqimore dhe mishit të freskët, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjieno-sanitare sipas standardeve në fuqi. Automjetet të jenë të pajisura me certifikatë higjieno-sanitare të lëshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit të jenë në pronësi ose me qera të operatorit ekonomik.

6. Shërbimi i shëndetësor ka të drejtën e kontrollit sipas ligjit mbi inspektoriatin sanitar.

7. Ushqimet do të nënshtrohen kontrollit të analizave biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit. Të gjithë artkujt si lende e paze të jenë të shoqëruara me Raport Analize.

MENAXHIMI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

1. Autoriteti kontraktor në çdo kohë, para fillimit të procesit të gatimit të artikujve ushqimorë, në prani të specialistëve të shërbimit të ushqimit dhe shërbimit shëndetësor të AS, si dhe të përfaqësuesve të operatorit ekonomik, të kontrollojnë: cilësinë e lëndëve të para për gatim, higjienën e lëndëve të para, ambientit të gatimit, mjeteve dhe personelit, dhe vetëm nëse ato plotësojnë kushtet dhe kërkesat sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë dokument, lejohet të vazhdojë procesi i përpunimit dhe gatimit të ushqimit.

2. Të verifikojë për çdo vakt numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore) të detajuar për çdo vakt (mëngjesi, dreka, darka)

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të marrë e të ruaj në kushte frigoriferike, në mjedisin e guzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar për çdo vakt, të vulosura nga mjeku dhe shërbimi i informacionit (oficeri i rojes), me një afat ruajtjeje deri në 24 orë. Në rastin e ankesave për cilësinë e ushqimit afati ruajtjeje së kampionëve zgjatet deri në daljen e rezultatit të analizave laboratorike.

4. Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të kontrollojë e të kërkojë operatorit ekonomik respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, zbatimin e normave të racioneve të ushqimit, si dhe higjienën në ambientet e gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit.

5. Autoriteti Kontraktor, nuk duhet të lejojë operatorin ekonomik që të përdor pajisje për gatim dhe inventare të imët për shpërndarjen e ushqimit jashtë specifikimeve të kërkuara në këtë shkresë dhe ato që përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit.

6. Autoriteti Kontraktor, nepermjet komisionit të ngritur me urdher të titullarit, do të regjistrojë veprimet ekonomike për sasinë e racioneve ditore të prodhuar në ditë (mëngjes, drekë, darkë), veprimet për likuidimin e detyrimeve të lindura ndaj operatorit ekonomik do të rregullohen me urdher të vecantë të titullarit të Autoritetit Kontraktor.

7. Operatori ekonomik duhet që, në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës (fletë-dalje provizore dhe bono) deri në konsumimin e plotë të tij. Ushqimi i gatuar sipas normave, të shoqërohet me dokument dalje provizore ditore.

8. Ushqimi i gatuar duhet të shpërndahet nga Sipërmarrësi pasi të jetë kontrolluar dhe firmosur për çdo vakt, nga personat përgjegjës në Akademin e Sigurisë, në librin e kontrollit të ushqimit, i cili do të qëndron pranë kuzhinës.

9. Autoriteti kontraktues, të njoftojë një ditë më parë operatorin ekonomik, për numrin e personave që do të përfitojnë e do të trajtohen ushqim në ditën pasardhese, duke përcaktuar numrin e tyre për secilin vakt (mëngjes, drekë, darkë).

Për realizimin e këtij shërbimi operatori ekonomik që do të shpallet fitues, në ditën e fillimit të kryerjes së shërbimit duhet të ketë në dispozicion në vendin e realizimit të shërbimit (Repartin e Nd.Shpejte), të gjitha mjetet e pajisjet e nevojshme bashkëkohore për realizimin e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit duke u bazuar dhe sipas pasqyrës nr.16 të Udhëzimit të përbashkët nr. 942 prot, datë 03.10.2017 të Ministrisë së Brendëshme dhe nr. 4130 prot. datë 05.10.2017, të Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë.

Normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit, për kuzhinën e mencën në Institucionet e Policisë së Shtetit

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia					
			deri 10 veta	11-30 veta	31-70 veta	Afati i përdorimit	Mbi 70-300 vetë	Afati i përdorimit
a	b	c	1	2	3	4	5	6
I.	PAISJE PËR KUZHINËN							
1	Afetatriç profesionale inox	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
2	Aspirator për thithjen e avujve të kuzhinës	copë	1	1	1	Pa afat	2 -3	Pa afat
3	Autokllavë inox profesionale ose lavastovilje.	copë	1	1	2	Pa afat	3	Pa afat
4	Braziere inox profesionale	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
5	Brumatriçe profesionale	copë	-	-	-	-	2	Pa afat
6	Dollap inoksi për enët	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
7	Formë ëmbëlsire për kuzhinë	copë	2	2	3	Pa afat	20	Pa afat
8	Frigorifer freskues inoksi	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat
9	Frigorifer ngrirës inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
10	Banak frigorifer	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat

11	Fritez inoxi profesionale	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
12	Frulador profesional	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
13	Furrë konveksionale inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
14	Garuzhde inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	6	Pa afat
15	Grirëse zarzavatesh profesionale	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat
16	Hanxhar mishi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
17	Tava inoxi shërbimi gastronom me kapak	copë	1	2	3	Pa afat	60	Pa afat
18	Insekt killer	copë	1	1	1	Pa afat	6	Pa afat
19	Tenxhere inoxi për gatim me kapak 20 rd.	copë	1	2	3	Pa afat	25	Pa afat
20	Kapse inoxi	copë	1	1	2	Pa afat	6	Pa afat
21	Karrele inoxi mbajtëse tavash	copë	-	-	1	Pa afat	4	Pa afat
22	Karoc inoxi transporti	copë	-	-	1	Pa afat	3	Pa afat
23	Karroc inoxi mbajtse pjatash me kosh	copë	-	-	-	Pa afat	4	Pa afat
24	Kosh mbeturinash plastik me kapak	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
25	Krepiere	copë	-	-	-	Pa afat	1	Pa afat
26	Kullese makaronash inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
27	Kuti me kapak për zarzavate	copë	1	1	2	Pa afat	40	Pa afat
28	Kuti polesteroli për transport	copë	1	1	2	Pa afat	30	Pa afat
29	Lavapjat inoxi profesionale me dy gropa	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
30	Lavapjat inoxi me dy gropa me sheshpushim	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
31	Lavastovilje një vaskë + lavaman inoxi	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
32	Limë e madhe për thika	copë	1	1	1	Pa afat	2	pa afat
33	Lopatë inoxi me vrima	copë	-	1	1	Pa afat	4	Pa afat
34	Lopatë inoxi për zgarë	copë	-	1	1	Pa afat	4	Pa afat
35	Makinë grirëse mishi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
36	Makinë për larje zaezavatesh	copë	-	-	-	Pa afat	2	Pa afat
37	Makinë qëruese patatesh	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
38	Makinë rrahse për ëmbëlsira	copë	-	-	-	Pa afat	2	Pa afat
39	Makineri për lazanje (brumi)	copë	-	-	-	Pa afat	1	Pa afat
40	Mikrovalë	copë	1	1	1	Pa afat	1	Pa afat
41	Peshore 300kg	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
42	Peshore elektronike deri 10 kg	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
43	Rafte inoxi	copë	-	-	2	Pa afat	8	Pa afat
44	Rente inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
45	Rrahse teli inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	8	Pa afat
46	Rrahse bifteku	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
47	Shpatull inoxi	copë	1	1	1	Pa afat	5	Pa afat
48	Shpatull thik inoxi ëmbëmbëlsire	copë	-	1	1	Pa afat	3	Pa afat
49	Shtrydhëse frutash profesionale	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
50	Sitë mielli	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat

51	Sobë me katër vatra	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
52	Sterizilues thikash digital	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
53	Tavë inoksi për gatim	copë	2	3	6	Pa afat	65	Pa afat
54	Tavolinë inoksi pune	copë	1	2	4	Pa afat	25	Pa afat
55	Trung mishi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
56	Teflon me ngjyra për përpunim zarzavatesh	copë	-	-	2	Pa afat	25	Pa afat
57	Thika buke	copë	2	2	3	Pa afat	6	Pa afat
58	Thik kuzhine	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
59	Thikë mishi	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
60	Tigan inoksi me bisht	copë	2	2	4	Pa afat	15	Pa afat
61	Tostier	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
62	Zgarë profesionale inoksi	copë	-	-	1	Pa afat	3	Pa afat
63	Dhomë frigoriferike	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
64	Dollap detergjentësh	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
65	Raft me çels inoksi për ruajtje mostre ushqimi	copë	1	-	1	Pa afat	1	Pa afat
66	Raft magazinimi	copë	1	1	2	Pa afat	30	Pa afat
II.	PAISJE PËR MENCËN					Pa afat		Pa afat
1	Banak shërbimi freskues	copë	-	1	1	Pa afat	6	Pa afat
2	Banak shërbimi inoksi neutro	copë	-	-	1	Pa afat	6	Pa afat
3	Banak inoksi shërbimi ngrohës	copë	-	-	1	Pa afat	6	Pa afat
4	Garuzhde 1 rd	copë	3	3	6	Pa afat	25	Pa afat
5	Garuzhde salce	copë	2	2	4	Pa afat	15	Pa afat
6	Gota uji qelqi	copë	30	60	150	Pa afat	700	Pa afat
7	Insekt killer	copë	2	2	3	Pa afat	6	Pa afat
8	Kana uji	copë	10	20	50	Pa afat	140	Pa afat
9	Kapse shërbimi buke	copë	1	2	2	Pa afat	10	Pa afat
10	Kapse shërbimi dy lugë	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
11	Karel mbajtëse tabakash	copë	1	1	2	Pa afat	25	Pa afat
12	Karrike	copë	10	30	80	Pa afat	300	Pa afat
13	Karrocë inoksi transporti	copë	-	1	2	Pa afat	6	Pa afat
14	Lugë shërbimi	copë	2	3	4	Pa afat	15	Pa afat
15	Lugë inoksi tavoline	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
16	Lugë inoksi për çaj	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
17	Mbajtëse lugë + Pirunj + gota	copë	1	1	2	Pa afat	10	Pa afat
18	Pirunj inoksi tavoline	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
19	Pirunj inoksi për ëmbëlsira	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
20	Pjata porcelani	copë	60	120	300	Pa afat	1200	Pa afat
21	Pjata qlqi ëmbëlsire	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
22	Tabaka vetëshërbimi	copë	15	35	80	Pa afat	400	Pa afat
23	Tas porcelani	copë	20	40	100	Pa afat	400	Pa afat
24	Tavolina mence katrore	copë	3	10	25	Pa afat	100	Pa afat
25	Tavolinë e rumbullakt	copë	1	2	4	Pa afat	25	Pa afat
26	Thikë inoksi tavoline	copë	2	4	10	Pa afat	50	Pa afat
27	Vajore set shërbimi	copë	2	4	20	Pa afat	110	Pa afat

Shtojca 5.

**LOTI 3 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”,
PËR REPARTIN E NDËRHRYJES SË SHPEJTË SHKODËR**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

I. Kërkesa të përgjithshme:

- Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara.
- **Ushqimi të gatuhet në ambientet e Repartit “Nderhyrjes Shpejte”.**
- **Servirja e ushqimit të bëhet në ambientet e Repartit “Nderhyrjes Shpejte”,**dhe ne ndjekje te levizjes se efektivit me sherbime apo stevitje larg dislokimit te reparti.
- Të gjitha riparimet e nevojshme që do të bëhen në ambientin e shpërndarjes së ushqimit, për vënien në punë dhe funksionimin sa më normal të tyre gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, do të bëhen nga sipërmarrësi me shpenzimet e veta dhe me miratimin e titullarit të autoritetit kontraktor.
- Ambientet e servirjes së ushqimit (mensa, ambientet ndihmese) do të mirëmbahen nga sipërmarrësi për funksionimin sa më normal të tyre, deri në përfundim të kontratës.
- Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë të gjitha orenditë e pajisjet bashkëkohore që nevojiten, për përpunim, gatim, shpërndarje, servirje, dhe konsumin e ushqimit, si dhe pajisjet për ruajtje te zakonshme dhe në kushte frigoriferike.
- Të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas standardeve në fuqi. Automjetet të jenë të pajisura me çertifikatë higjeno-sanitare të lëshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit të jenë në pronësi ose me qera të vërtetuara me dokumenta.
- Operatori ekonomik të disponojë mjete transporti frigoriferike, për transport të produkteve ushqimore ne vendin ku do te jetë dislokuar efektivit i repartit në rastet e daljes së punonjësve në stërvitje verore/dimërore apo në shërbime operationale jashtë rrethit. Mjetet e pajisjet te jenë të përshtatshme edhe për kushte të vështira terreni.
- Për ambientin e marrë me qira, me përjashtim të ambienteve që përdoren për servirjen e ushqimit, sipërmarrësi të paguajë qiranë e këtij ambienti, sipas VKM-së nr. 672, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar.
- Furnizimi me ujë dhe energji elektrike do të kryhet nga vetë operatori ekonomik sipas kontratave që do të lidhë me entet përkatëse furnizuese. Për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit është e nevojshme qe në rast ndërprerjeje të burimeve të furnizimit të vere në dispozicion burime alternative furnizimi.

-
- Sipërmarrësi që do të kryej këtë shërbim, duhet të lidhë kontratë për energjinë dhe ujin e pijshëm, me institucionet përkatëse (OSHEE dhe Ujësjellësin) duke zbatuar të gjitha rregullat dhe udhëzimet përkatëse.
 - Të bëjë shpërndarjen e ushqimit të gatuar sipas orarit të përcaktuar.
 - Sipërmarrësi duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm të kualifikuar dhe me eksperience për të garantuar cilësinë e ushqimit dhe shërbimin ndaj punonjësve.
 - Sipërmarrësi është përgjegjës për të gjitha dëmtimet që mund t'i shkaktohen shëndetit të punonjësve nga ushqimi i furnizuar.
 - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontrolle për zbatimin e kushteve të kontratës gjatë të gjitha fazave të procesit (furnizimit të lëndës së parë, përpunimit, gatimit dhe shpërndarjes).
 - Sipërmarrësi është përgjegjës për sigurimin e kushteve të higjienës në të gjitha ambientet e shpërndarjes së ushqimit.
 - Në zbatim të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 34, pika 9, paragrafi i parë dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12, pika 10, Autoriteti/Enti kontraktor do të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

PROGRAMI USHQIMOR

1. Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave dhe atyre të zëvendësimit të paraqitura në dokumentet e tenderit. Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimorë sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.

Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara në normën bazë të ushqimit dhe menynë javore të miratuar nga autoriteti kontraktor.

Zarzatat duhet të përdoren gjithmonë të freskëta dhe asnjëherë të konservuara si dhe duhet të plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH. Produktet ushqimore që do të përpunohen, do të depozitohen në ambientet e kuzhinës të repartit dhe të jenë të shoqëruara me flete analize përkatëse.

Mishi duhet të jete mish viçi i freskët vendi, me moshë jo më shumë se 1(një) vit, cilësia e parë dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar bazuar në STASH 1441 /87.

Produktet ushqimore duhet të jenë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse dhe certifikatën e origjinës së mallit.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menysë javore të ushqimit të miratuar, konformë normave bazë të ushqimit.

Menyja e ushqimit duhet të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normave bazë të ushqimit.

Programi Ushqimor

Llojshmëria e ushqimit, sasia e cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi e menyja e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë të repartit Nderhyrja e Shpejte, në bazë të normave.

Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menysë ditore dhe javore të ushqimit, sipas programit të miratuar nga titullari i repartit.

Programi ushqimor do të jetë i veçante për të dy rastet për vaktin drekë sipas normës së vaktit drekë dhe me tre vakte sipas normës ushqimore të forcës operationale.

Programi ushqimor do të siguroje sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura. Sasia dhe cilësia e ushqimeve që furnizohen nga sipërmarrësi duhet t'u përgjigjen kushteve që përcakton Ligji "Për Ushqimin".

2-Servirja e ushqimit

Shpërndarja e ushqimit do të bëhet nga operatori ekonomik në mensën e repartit dhe në rastet e daljes së efektivave jashtë repartit, servirja do bëhet nga operatori ekonomik me paisjet e tij, atje ku ato janë dislokuar.

Shpërndarja e ushqimit do të realizohet me vetëshërbim. Personeli sipas orarit të ngrënies së ushqimit do të shkojë i lirë në mensë dhe do shërbehet konformë rregullave e standardeve të kërkuara.

Servirja e ushqimit do të bëhet në banakë inoxi. Ushqimi i servirur do të jetë gjithmonë i ngrohtë, brenda orarit të ngrënies së ushqimit.

Orari i konsumit të ushqimit do të jetë:

MËNGJESI -	Ora 07.00-07.55
DREKA -	Ora 13.00-15.00
DARKA -	Ora 19.00-20.00

Operatori ekonomik do të sigurojë personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për të siguruar në kohë gatimin dhe servirjen e shpejtë dhe me kulturë të ushqimit.

Të sigurojë vendin dhe sasinë e mjaftueshme dhe të shumëllojshme me pjata porcelani, tabaka për marrjen e ushqimit e mjeteve të tjera të nevojshme për ngrënien e ushqimit nga personeli.

Mensa në mënyrë permanente të jetë e kompletuar nga operatori ekonomik me tavolina, karrike mbulesa tavolinash (letre), komplete servirje inoxi për çdo 4 veta me vaj ulliri, uthull, kripë, erëza e kruajtëse dhëmbësh; me gota uji për çdo person dhe kanë uji për çdo 4 veta; me lugë, pirun e thika inoxi; me mbajtëse frutash e bukë për çdo 4 veta si dhe kartepeceta për çdo person.

Në dalje të mensave të jenë të vendosur në mënyrë permanente karrocet portative për vendosjen e tabakave të servirjes pas ngrënies së ushqimit nga personeli.

3. Kërkesa higjieno-sanitare

Operatori ekonomik duhet të garantojë e sigurojë ushqim të freskët dhe të mbrojtur nga kontaminimet.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit sipas ligjit mbi inspektoratin sanitar.

Operatori ekonomik të sigurojë një ambient siç përcaktohet në standardin ISO, për gatimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve si dhe një sistem ajrimi dhe kondicionimi me temperaturë normale.

Operatori ekonomik të sigurojë detergjentë në vendet e larjes së duarve me ujë të ngrohtë e të ftohtë dhe mjete për tharjen e tyre.

Operatori ekonomik të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve, frutave etj.

Operatori ekonomik në rastet e ndërprerjes së furnizimit me ujë nga rrjeti duhet ta sigurojë atë vetë dhe me mjetet e tij.

Personeli i kuzhinës dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jenë kontrolluar për gjëndjen shëndetësore dhe higjienike, duke i pajisur me librezën përkatëse shëndetësore nga inspektorati i higjienës. Rifreskimi i librezave shëndetësore të bëhet çdo 6 muaj.

Personeli i shërbimit të ketë uniformë pune me stampën e logos së operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik është i detyruar të transportojë e depozitojë mbeturinat të ambalazhuara, në vendin e depozitimit të tyre të përcaktuar nga Bashkia apo Njësia Administrative.

4. Kërkesa të organizimit e menaxhimit të ushqimit (kontrolli dhe forca ditore)

Forca ditore e ushqimit sipas rastit do të përbëhet nga:

1- numri i punonjësve që trajtohen me vaktin drekë.

2- numri i punonjësve që trajtohen me normën e forcës operationale me tre vakte.

Te drejtën e ndryshimit të orarit për shpërndarjen e ushqimit e ka titullari i Autoritetit Kontraktor ndërsa sipërmarrësi të respektojë orarin e përcaktuar.

Çdo ditë operatori ekonomik të dokumentojë sasinë e ushqimit të përgatitur dhe konsumuar me fletë-dalje, të cilën bashkë me raportin e Situatës Ditore, të dorëzohen në financën e Autoritetit Kontraktor për likuidim çdo muaj.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t'i nënshtrohet kontroleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menysë javore, nga komisioni i pritjes dhe pranimit të ushqimit i ngritur me urdhër të Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor është i detyruar të ruajë në kushte frigoriferike në mjedisin e kuzhinës kampionet e ushqimit të gatuar sipas rastit për një ose tre vaktet. Afati i ruajtjes së kampioneve është 24 orë dhe vulozet nga mjeku dhe oficeri i rojës. Kur ka ankesa për

cilësinë e ushqimit ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

Operatori ekonomik me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Autoritetin Kontraktor çdo muaj për racione ditore të porositura sipas normave përkatëse, të bazuara në raport-situatat e lëshuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe pasqyrës përmbledhëse mujore.

Likuidimi i vlerës së ushqimit të gatuar do të kryhet në fund të çdo muaji në bazë të forcës ditore të porositur, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të konsumit ditor gjatë gjithë muajit të përcaktuar në kontratë, sipas akt-rakordimit mujor të firmosur nga të dy palët në sasi dhe vlerë.

Ushqimi i gatuar duhet të shpërndahet nga operatori ekonomik pasi të jetë kontrolluar dhe firmosur për çdo vakt nga përfaqësues të Autoritetit Kontraktor në librin e kontrollit të ushqimit, i cili qëndron pranë kuzhinës dhe ruhet nga Autoriteti Kontraktor në të njëjtin vend me kampionet e ushqimit.

5. Ambientet dhe vendet e punës .

Ambientet duhet të plotësojnë normat higjieno sanitare, kushtet teknike nga ana ndërtimore, si dhe impiantet elektrike, hidraulike, gazi dhe shkarkimet e ujërave të cilat do të vihen në funksionim për përdorim nga sipërmarrësi, brenda normave teknike dhe afatit të përcaktuar nga palët. Këto ambiente do të mirëmbahen nga sipërmarrësi deri në përfundimin e afatit të kontratës.

Çdo ndërhyrje në infrastrukturën e ambienteve të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit bëhet me miratim të titullarit të Autoritetit Kontraktor. Riparimet e nevojshme do të pasqyrohen me preventivat dhe situacionet përkatëse dhe përballohet nga kontraktuesi (sipërmarrësi). Këto preventiva do të miratohen nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe do të jenë pjesë e kontratës.

6. Inventari i imet për ndarjen e ushqimit

Për realizimin e këtij shërbimi operatori ekonomik që do të shpallet fitues, në ditën e fillimit të kryerjes së shërbimit duhet të ketë në dispozicion në vendin e realizimit të shërbimit (Repartin e Nd.Shpejte), të gjitha mjetet e pajisjet e nevojshme bashkëkohore për realizimin e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit duke u bazuar dhe sipas pasqyrës nr.16 të Udhëzimit të përbashkët nr. 942 prot, datë 03.10.2017 të Ministrisë së Brendëshme dhe nr. 4130 prot. datë 05.10.2017, të Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë.

Normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit, për kuzhinën e mencën në Institucionet e Policisë së Shtetit

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia					
			deri 10 veta	11-30 veta	31-70 veta	Afati i përdorimit	Mbi 70-300 vetë	Afati i përdorimit
a	b	c	1	2	3	4	5	6
I.	PAISJE PËR KUZHINËN							
1	Afetatriç profesionale inox	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
2	Aspirator për thithjen e avujve të	copë	1	1	1	Pa afat	2 -3	Pa afat

	kuzhinës							
3	Autokllavë inox profesionale ose lavastovilje.	copë	1	1	2	Pa afat	3	Pa afat
4	Braziere inox profesionale	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
5	Brumatriçe profesionale	copë	-	-	-	-	2	Pa afat
6	Dollap inoksi për enët	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
7	Formë ëmbëlsire për kuzhinë	copë	2	2	3	Pa afat	20	Pa afat
8	Frigorifer freskues inoksi	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat
9	Frigorifer ngrirës inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
10	Banak frigorifer	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat
11	Fritez inoksi profesionale	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
12	Frulator profesional	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
13	Furrë konveksionale inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
14	Garuzhde inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	6	Pa afat
15	Grirëse zarzavatesh profesionale	copë	-	1	1	Pa afat	2	Pa afat
16	Hanxhar mishi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
17	Tava inoksi shërbimi gastronom me kapak	copë	1	2	3	Pa afat	60	Pa afat
18	Insekt killer	copë	1	1	1	Pa afat	6	Pa afat
19	Tenxhere inoksi për gatim me kapak 20 rd.	copë	1	2	3	Pa afat	25	Pa afat
20	Kapse inoksi	copë	1	1	2	Pa afat	6	Pa afat
21	Karrele inoksi mbajtëse tavash	copë	-	-	1	Pa afat	4	Pa afat
22	Karoc inoksi transporti	copë	-	-	1	Pa afat	3	Pa afat
23	Karroc inoksi mbajtse pjatash me kosh	copë	-	-	-	Pa afat	4	Pa afat
24	Kosh mbeturinash plastik me kapak	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
25	Krepiere	copë	-	-	-	Pa afat	1	Pa afat
26	Kullese makaronash inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
27	Kuti me kapak për zarzavate	copë	1	1	2	Pa afat	40	Pa afat
28	Kuti polesteroli për transport	copë	1	1	2	Pa afat	30	Pa afat
29	Lavapjat inoksi profesionale me dy gropa	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
30	Lavapjat inoksi me dy gropa me sheshpushim	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
31	Lavastovilje një vaskë + lavaman inoksi	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
32	Limë e madhe për thika	copë	1	1	1	Pa afat	2	pa afat
33	Lopatë inoksi me vrima	copë	-	1	1	Pa afat	4	Pa afat
34	Lopatë inoksi për zgarë	copë	-	1	1	Pa afat	4	Pa afat
35	Makinë grirëse mishi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
36	Makinë për larje zaezavatesh	copë	-	-	-	Pa afat	2	Pa afat
37	Makinë qëruese patatesh	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
38	Makinë rrahse për ëmbëlsira	copë	-	-	-	Pa afat	2	Pa afat
39	Makineri për lazanje (brumi)	copë	-	-	-	Pa afat	1	Pa afat
40	Mikrovalë	copë	1	1	1	Pa afat	1	Pa afat
41	Peshore 300kg	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
42	Peshore elektronike deri 10 kg	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat

43	Rafte inoksi	copë	-	-	2	Pa afat	8	Pa afat
44	Rente inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
45	Rrahse teli inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	8	Pa afat
46	Rrahse bifteku	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
47	Shpatull inoksi	copë	1	1	1	Pa afat	5	Pa afat
48	Shpatull thik inoksi ëmbëmbëlsire	copë	-	1	1	Pa afat	3	Pa afat
49	Shtrydhëse frutash profesionale	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
50	Sitë mielli	copë	1	1	1	Pa afat	2	Pa afat
51	Sobë me katër vatra	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
52	Sterizilues thikash digital	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
53	Tavë inoksi për gatim	copë	2	3	6	Pa afat	65	Pa afat
54	Tavolinë inoksi pune	copë	1	2	4	Pa afat	25	Pa afat
55	Trung mishi	copë	1	1	1	Pa afat	3	Pa afat
56	Teflon me ngjyra për përpunim zarzavatesh	copë	-	-	2	Pa afat	25	Pa afat
57	Thika buke	copë	2	2	3	Pa afat	6	Pa afat
58	Thik kuzhine	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
59	Thikë mishi	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
60	Tigan inoksi me bisht	copë	2	2	4	Pa afat	15	Pa afat
61	Tostier	copë	1	1	2	Pa afat	4	Pa afat
62	Zgarë profesionale inoksi	copë	-	-	1	Pa afat	3	Pa afat
63	Dhomë frigoriferike	copë	-	-	1	Pa afat	2	Pa afat
64	Dollap detergjentësh	copë	-	-	1	Pa afat	1	Pa afat
65	Raft me çels inoksi për ruajtje mostre ushqimi	copë	1	-	1	Pa afat	1	Pa afat
66	Raft magazinimi	copë	1	1	2	Pa afat	30	Pa afat
II.	PAISJE PËR MENCËN					Pa afat		Pa afat
1	Banak shërbimi freskues	copë	-	1	1	Pa afat	6	Pa afat
2	Banak shërbimi inoksi neutro	copë	-	-	1	Pa afat	6	Pa afat
3	Banak inoksi shërbimi ngrohës	copë	-	-	1	Pa afat	6	Pa afat
4	Garuzhde 1 rd	copë	3	3	6	Pa afat	25	Pa afat
5	Garuzhde salce	copë	2	2	4	Pa afat	15	Pa afat
6	Gota uji qelqi	copë	30	60	150	Pa afat	700	Pa afat
7	Insekt killer	copë	2	2	3	Pa afat	6	Pa afat
8	Kana uji	copë	10	20	50	Pa afat	140	Pa afat
9	Kapse shërbimi buke	copë	1	2	2	Pa afat	10	Pa afat
10	Kapse shërbimi dy lugë	copë	2	2	3	Pa afat	10	Pa afat
11	Karel mbajtëse tabakash	copë	1	1	2	Pa afat	25	Pa afat
12	Karrike	copë	10	30	80	Pa afat	300	Pa afat
13	Karrocë inoksi transporti	copë	-	1	2	Pa afat	6	Pa afat
14	Lugë shërbimi	copë	2	3	4	Pa afat	15	Pa afat
15	Lugë inoksi tavoline	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
16	Lugë inoksi për çaj	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
17	Mbajtëse lugë + Pirunj + gota	copë	1	1	2	Pa afat	10	Pa afat
18	Pirunj inoksi tavoline	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat

19	Pirunj inoksi për ëmbëlsira	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
20	Pjata porcelani	copë	60	120	300	Pa afat	1200	Pa afat
21	Pjata qlqi ëmbëlsire	copë	15	35	80	Pa afat	350	Pa afat
22	Tabaka vetëshërbimi	copë	15	35	80	Pa afat	400	Pa afat
23	Tas porcelani	copë	20	40	100	Pa afat	400	Pa afat
24	Tavolina mence katrore	copë	3	10	25	Pa afat	100	Pa afat
25	Tavolinë e rrumbullakt	copë	1	2	4	Pa afat	25	Pa afat
26	Thikë inoksi tavoline	copë	2	4	10	Pa afat	50	Pa afat
27	Vajore set shërbimi	copë	2	4	20	Pa afat	110	Pa afat

8. Normat Ushqimore

Punonjësit e policisë te trupes operacionale” përfitojnë trajtim me ushqim, pa pagesë sipas dhe në zbatim të VKM. nr. 189 datë 15.03.2017,”Për trajtimin me ushqim të punonjësve të policisë së shtetit,të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të policisë së shtetit si dhe shtetasve të ndaluar ose të arrestuar,deri në sqarimin e situatës së tyre.” Pika 1, germa”a”, (i,ii) dërguar me Shkresën nr.2964, date 07.06.2017 “Mbi dergimin per zbatim te VKM NR.189, date 15.03.2017” të Drejtorit te Drejtorise se Mbeshtetjes Logjistike.

Trajtimi i punonjësve bëhet me Normën e trupes operacionale me tri vakte, për rastet kur janë të angazhuar në veprime operacionale apo gatishmërie, kur kohëzgjatja e punës është më shumë se 8 (tetë) orë dhe me Normën me normën Vakti “Dreke”, për ditët e zakonshme kur kohëzgjatja e punës është deri 8 (tetë) orë.

Norma ushqimore me një vakt dhe tre vakte janë të përcaktuara në Udhëzimin e perbashket nr. 942 prot, datë 03.10.2017 të Ministrisë së Brendshme dhe nr. 4130 prot, datë 05.10.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë ”Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjesve te Policise se Shtetit, studenteve dhe kursanteve ne institucionet arsimore te Policisë së Shtetit si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”, pasqyra nr.1 dhe pasqyra nr.5, dërguar me shkresen nr. 5784 prot, datë 15.11.2017, të Drejtorit të Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike.

Operatori që shpallet fitues, për çdo stinë të vitit të pregatisë një meny javore, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

8. Normat Ushqimore

Punonjësit e policisë te trupes operacionale te RepartitN.Sh.” përfitojnë trajtim me ushqim, pa pagesë sipas dhe në zbatim të VKM. nr. 189 date 15.03.2017,”Për trajtimin me ushqim të punonjësve të policisë së shtetit,të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të policisë së shtetit si dhe shtetasve të ndaluar ose të arrestuar,deri në sqarimin e situatës së tyre.” Pika 1a, (i,ii) dërguar me Shkresën nr.2964, date 07.06.2017 “Mbi dergimin per zbatim te VKM NR.189, date 15.03.2017” te Drejtorit te Drejtorise se Mbeshtetjes Logjistike.

Trajtimi i efektivit (trupe operacionale) bëhet me tri vakte, për rastet kur janë të angazhuar në veprime operacionale apo gatishmërie , kur kohëzgjatja e punës është më shumë se 8 (tetë) orë dhe me Normën me normën Vakti “Dreke”, për ditët e zakonshme, kur kohëzgjatja e punës është më shumë se 8 (tetë) orë.

Norma ushqimore me një vakt dhe tre vakte janë të përcaktuara në Udhëzimin e perbashket nr. 942 prot, datë 03.10.2017 të Ministrisë së Brendshme dhe nr. 4130 prot, datë 05.10.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjesve te Policise se Shtetit, studenteve dhe kursanteve ne institucionet arsimore te Policisë së Shtetit si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre", **pasqyra nr.2 dhe pasqyra nr.5**, dërguar me shkresen nr. 5784 prot, datë 15.11.2017, të Drejtorit të Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike.

Operatori që shpallet fitues, për çdo stinë të vitit, të pregatisë një meny javore, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

- **Artikujt ushqimor për një racion ditor të Normës për Forcat e Nd.Shpejte (3 vakte):**

Tab.2

Nr	Artikujt Ushqimore sipas normës	Njësia Matëse	Norma e trupes op.	
			Sasia	Energjia ne K/Cal
1	Buke gruri	gr	450	1102.5
2	Miell tip 00	gr	15	51.45
3	Oriz	gr	60	217.2
4	Fasule	gr	50	155.5
5	Makarona	gr	60	213.6
6	Mish viçi fresket	gr	250	360
7	Sallam	gr	50	227
8	Vaj	gr	40	360
9	Gjalp	gr	30	227.4
10	Sheqer	gr	50	196
11	Kripe	gr	5	0
12	Djathe i bardhe	gr	100	250
13	Perime per gatim e sallate.	gr	450	85.5
14	Patate	gr	200	170
15	Salce	gr	6	3
16	Çaj mali	gr	3	3.24
17	Fruta	gr	450	202.5
18	Recel	gr	20	41.8
19	Çokollate	gr	30	169.5
20	Qumësht i freskët (litra)	gr	400	196
21	Veze (2 kokrra)	gr	120	187.2
22	Erëza	gr	3	1.98
	Totali kalori			4421.37

- **Artikujt ushqimor për një racion ditor te Normës për Vaktin "Dreke"**

Tab.5

Nr	Artikujt Ushqimore sipas normës	Njësia Matëse	Norma Vakti "Dreke"	
			Sasia	Energjia ne K/Cal

1	Buke gruri	gr	200	490
2	Miell tip 00	gr	15	51.45
3	Oriz/makarona	gr	50	359
4	Mish viçi fresket	gr	120	172.8
5	Vaj	gr	25	225
6	Gjalp	gr	10	75.8
7	Veze 1/2 (kokrra)	kokrra	0.5	46.8
8	Sheqer	gr	20	78.4
9	Kripe	gr	5	0
10	Perime per gatim e sallate.	gr	350	66.5
11	Salce	gr	6	3
12	Fruta	gr	300	135
13	Erëza	gr	3	1.98
	Total kalori			1705.73

Normat e zëvendësimit (sipas pasqyres nr.13 të Udhezimit te perbashket nr. 942 prot, datë 03.10.2017 të Ministrise së Brendeshme dhe nr. 4130 prot, datë 05.10.2017 të Ministrise së Shëndetësisë).

Ekivalentët ushqimorë sipas nëngrupeve ushqimore me origjinë të njëjtë

Nr.	Grupi i ushqimeve	Ekivalentet ushqimore
1.	Qumësht dhe nënprodukte të tij	
	125 gr qumësht =	125 gr kos
		100 gr djath të bardhë
		50 gr djath kaçkavall
2.	Mish peshk dhe vezë	
	100 gr mish viçi/derri/lope etj =	100 gr mish të bardhë (pulë, gjeli,lepuri)
		50 gr sallam/proshutë
		150 gr peshk /fruta deti (të freskëta ose të ngrira)
		50 gr konservë peshku
		50 gr vezë
3.	Bishtajoret	
	150 gr bishtajore të freskëta (mashurka, bizele)=	50 gr fasule e thatë
		50 gr thierza
4.	Drithërat dhe nënproduktet e tyre	
	50 gr bukë=	80 gr oriz
		80 gr makarona
		80 gr misër
		50 gr kroasan/ kek, etj
		30 gr drithëra për mëngjes (cornflax/ musli/)
		200 gr patate
5.	Frutat	
	150 gr fruta të freskëta =	30 gr fruta të thata (arra, bajame, kikirikë, etj)

		30 fruta të thata sheqerosura
6.	Yndyrnat	
	10 ml vaj ulliri ose farërash (misri. Luledielli)=	10 gr gjalp

Lista e ushqimeve qe luftojne stresin.

- Bajamet
- Patatja e embel, panxhari i kuq, rrepa e kuqe
- Gjize nga qumesht dhie
- Pjepri,rrushi ,kivi,manaferrat,çaji jeshil, uji me limon
- Brokoli, kungujt, mashurkat jeshile,bizelet, karotat ,domatet, hudhra.
- Salmoni dhe peshqit e ujrave te ftohta.

Zëvendësimi i artikujve sipas tabelave te mësipërm përdoren vetëm ne rastet kur merret miratim nga titullarit te Autoritetit Kontraktor.

Lista e ushqimeve të normës e shprehur si pjesë e ngrënshme, produkt i plotë, sipas pasqyres nr.14 e Udhezimit te perbashket nr. 942 prot. Date 03.10.2017 te Ministrise se Brendeshme dhe nr. 4130 prot. Date 05.10.2017 te Ministrise te Shendetesise.

Nr.	Ushqimet	Sasia /gr pjesë e ngrënshme	Koeficienti ushqimor për pjesë të ngrënshme ushqimi/100 gr e shprehur në %	Sasia / gr pjesë e plotë e ushqimit
1	Bukë gruri masive	450	100	450
2	Oriz	60	100	60
3	Makarona	60	100	60
4	Fasule	50	100	50
5	Mish viçi	270	60	378
6	Vaj ushqimor	40	100	40
7	Gjalp i freskët	40	100	40
8	Sheqer	50	100	50
9	Sallam	50	100	50
10	Djath i bardhë	100	100	100
11	Qumësht	500	100	500
12	Veze (2 kokrra mesatare)	120	100	120
13	Patate	200	83	234
14	Perime për gatim + sallatë	450	85	517,5
15	Fruta	450	78	549
16	Reçel	30	100	30
17	Salcë domate	10	100	10
18	Çaj mali	4	100	4
19	Kripë	10	100	10
20	Erëza	3	100	3
21	Miell tip 00	20	100	20
22	Çokollata	40	100	40

Lista e disa perimeve dhe frutave e shprehur si pjesë e ngrënshme, produkt i plotë sipas pasqyres nr.14 e Udhezimit te perbashket nr. 942 prot. Date 03.10.2017 te Ministrise se Brendeshme dhe nr. 4130 prot. Date 05.10.2017 te Ministrise te Shendetesise.

Nr.	Perime	Koeficienti ushqimor për pjesë të ngrënshme ushqimi/100 gr e shprehur në %
1	Patëllxhane	92
2	Karrota	95
3	Qepa	83
4	Speci	82
5	Domate	100
6	Spinaq	83
7	Presh	77
8	Lakra	94
9	Lulelakër	66
10	Brokoli	77
11	Kastravec	77
12	Molla	85
13	Portokalle	80
14	Pjeshka	91
15	Kajsi	94
16	Shalqi	52
17	Pjepër	47
18	Rrush	94
19	Dardhë	84

Shtojca 5.

**LOTI 4 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”,
PËR DREJTORINË VENDORE TË POLICISË, TIRANË.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Norma per shtetasit e ndaluar dhe te arrestuar eshte si me poshte:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Buke R.75	kg	0.4
2	Oriz	kg	0.04
3	Makarona	kg	0.04
4	Fasule	kg	0.04
5	Mish viçi	kg	0.08
6	Vaj ushqimore	kg	0.03
7	Sheqer	kg	0.02
8	Djath I bardhe	kg	0.04
9	Qumesht I fresket	kg	0.25
10	Veze	kokerr	1
11	Perime gatim +sallate	kg	0.3
12	Fruta(molle+portokall)	kg	0.2
13	Salce	kg	0.004
14	Çaj mali	kg	0.002
15	Kripe	kg	0.005

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE E USHQIMI”

- Operatori Ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
- Produktet ushqimore, lënda e parë, që do të përpunohen, trajtohen apo ambalazhohen në ambjentet e kuzhinës që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse.
- O.E. duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmshëmrisë së tij sipas VKM-së Nr.760 datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshët përgjatë ushqimit ushqimor” dhe analizave të ujit që përdor.
- Magazinimi i lëndës së parë duhet të bëhet në dy forma:
 - a. Në temperaturë ambjenti

b. Në frigorifer ose dhoma frigoriferike

- Magazinimi në temperaturë ambiente bëhet në dollape/rafte metalike të lyera me ngjyrë të qartë në ambiente të destinuara eskuzivisht për depozitimin e ushqimeve. Këto mjete janë të lashme për të thjeshtuar operacionet e pastrimit të sipërfaqeve.

Këto mjete janë bërë në mënyrë të tillë që të mos lihen volume bosh ose vende që mund të përbëjnë sipërfaqe kolonizimi nga insektet ose mikrobet.

- Magazinimi në frigorifer ose dhomë frigoriferike bëhet në temperatura të ndryshme në funksion të produktit që konservohet duke filluar nga temperatura maksimale +5°C deri në -22°C. Të gjithë frigoriferët duhet të kenë një display të jashtëm me treguesit e temperaturës.
 - Vazhdimësia e energjisë elektrike tek motorët e frigoriferëve duhet të jetë e garantuar me gjeneratorë në pronësi të kompanisë.
 - Kushtet higjienike të lëndës së parë në fazën e stokimit duhet të jenë nën kontrollin e përgjegjësit të magazinës.
- Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 date 28.01.2008 “ Per Ushqimin “ i ndryshuar , për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e percaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit , kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
 - Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standardeve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi , konform manualit të vetkontrollit të HACCP .
 - Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e vecanta deri të konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme (termuse) tëellojeve dhe të madhësive të ndryshme në funksion të sasise që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit)
 - Produktet ushqimore (lenda e parë) që do të përpunohen , trajtohen apo ambalazhohen në ambientet e përpunimit (kuzhines) që disponon sipërmarresit do të jenë të shoqëruara me flete analize përkatëse
 - Operatori ekonomik , të respektojë rregullat e higjienës për larjen , pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve , frutave , sipas kërkesave të ligjeve në fushën e higjienës dhe ushqimit.
 - Operatori për qëllime higjienë dhe pastrimi të përdorë detergjente dhe solucione kimike të certifikuar nga institucionet e njohura me ligj dhe të padëmshme për shëndetin e njerezve të percaktuara sipas akteve përkatëse (Urdhëri Nr. 365 dt. 03.08.2012 i Ministrisë të Shëndetësisë “ Për miratimin e listës dhe përdorimin e lendeve që përdoren për dezinfektim , deratizim dhe insektizim në shëndet publik”)
 - Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjienë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhines , ambienteve të gatimit , atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave .
 - Operatori duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren . Pastrimi i inventarit të imet kryhet nga operatori ekonomik , i cili duhet të mbajë dhe rregjistrat e pastrimit.
 - Në rast të sëmundjeve infektive, të përdoren për shpërndarje të ushqimit vetëm pajisje të vecanta dhe një përdorimeshe .
 - Operatori ekonomik , do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit , shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit , në vendet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash.

- Materiali ne kontakt me ushqimin (termuset , enet etj me te cilat transportohet ushqimi) te jene material i pershtatshem dhe lehtesisht te pastrueshme , sipas kerkesave te Udhezimit te Ministrit te Bujqesise Nr. 22 , date 25.11.2010 “ Kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjienes per stabilimentet e ushqimit dhe operoret e biznesit ushqimor “, me mbyllje hermetike (per te sigurua

mbrojtjen nga mjedisi i jashtem) . Enet qe perdoren per transportin dhe /ose shperndarjen e ushqimit duhet te jene me material jo te demshem per shendetin.

- Punonjesit e operatorit ekonomik ne momentin e pergatitjes / sherbimit te ushqimit ne ambientet e autoritetit kontraktor , duhet te jene pajisur me uniformen , veshjen perkatese te punes (perparese , grykese , kepuce pantallona) , keta te fundit te jene te pajisur me libreze shendetesore.
- Operatori ekonomik duhet qe ne cdo kohe te shoqeroje ushqimin e gatuar me dokumentacionin perkates deri ne konsumimin e plote te tij dhe te garantoje sigurine e produktit nepermjet gjurmueshmerise se tij , sipas VKM Nr. 760, date 16.09.2015 “ Per kerkesat per gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit per kafshe pergjate zinxhirit ushqimor” dhe analizave te ujit qe perdor .
- Operatori ekonomik eshte i detyruar te ruaje ne rafte te vecanta ne mjedisin e kuzhines, kampionet e ushqimit te gatuar e qe shperndahet per ngrenie per te gjitha vaktet. Afati i ruajtjes se mostrave (kampioneve) eshte 24 – ore. Kur ka denoncime per cilesine e ushqimit, ky afat zgjat deri ne zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave .
- Operatori ekonomik , do te mbuloje shpenzimet ekonomike te nevojshme per realizimin e analizave laboratorike te mostrave te ushqimit te gatuar, sa here qe kerkohet nga autoriteti kontraktor.

Nga Operatori ekonomik privat kerkohet te plotesohet:

Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.189, date 15.03.2017 "Per trajtimin me ushqim te punonjesve te Policise se Shtetit, te studenteve dhe te kursanteve ne institucionet arsimore te Policise se Shtetit si dhe shtetasve te ndaluar ose te arrestuar, deri ne sqarimin e pozites se tyre, normave e kalorive perkatëse të miratuara në Udhezimin të përbashket të Ministrisë së Brendshme me Nr.942 , date 03.10.2017 dhe të Ministrisë së Shendetësisë Nr.4130 datë 05.10.2017 “Per miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjesve të Policise se Shtetit, studentëve dhe kursantëve ne institucionet arsimore te Policisë se Shtetit si dhe te shtetasve të ndaluar ose te arrestuar deri në sqarimin e pozitës së

tyre “, Pasqyra Nr.4 “Norma e ushqimore për shtetasit e ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre (të huaj dhe shqiptarë”.

Sipermarresi eshte i detyruar te siguroje te gjitha orendite e pajisjet qe nevojiten, per transport, shperndarje dhe servirje.

Kontraktuesi duhet te realizoje shërbimin e ushqimit sipas normave te miratuara ne pasqyren Nr.4 te Normave te ushqimit sipas sasisë e kalorive përkatëse te miratuara.

Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara në Udhezimin të përbashket të Ministrisë së Brendshme me Nr.942 , date 03.10.2017 dhe të Ministrisë së Shendetësisë Nr.4130 datë 05.10.2017 “Per miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjesve të Policise se Shtetit, studentëve dhe kursantëve ne institucionet arsimore te Policisë se Shtetit si dhe te shtetasve të ndaluar ose te arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre “,

Pasqyra Nr.4 bashkëlidhur “Norma e ushqimore për shtetasit e ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre (të huaj dhe shqiptarë”.

Sipërmarresi është i detyruar të sigurojë të gjitha orenditë e pajisjet që nevojiten, për transport, shpërndarje dhe servirje, si dhe pajisje për ruajtje të zakonshme dhe në kushte frigoriferike në ambientet e Komisariateve e DVP Tiranë ku serviret ushqimi.

Zarzavatet duhet të përdoren gjithmonë të freskëta dhe asnjëherë të konservuara si dhe duhet të plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH të shoqëruara me flete analize përkatëse.

Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara në urdhrat dhe VKM.

Mishi duhet të jetë mish viçi i freskët, cilësia e parë dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar, bazuar në STASH.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë javore të ushqimit të miratuar, konformë normës bazë të ushqimit e cila duhet të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kalorinë e duhura sipas normës bazë të ushqimi.

Sherbimi do të serviret në vartësi të numrit të të ndaluarve, sipas orarit të përcaktuar për të tre vaktet e ngrënies së ushqimit në DVP Tiranë dhe në Komisaritet Nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Vore sipas vendndodhjeve të tyre.

Shpërndarja e ushqimit deri tek të ndaluarit në çdo Komisariat Policie do të bëhet me pajisje të përshtatshme të ambalazuara bazuar në specifikën që mbart ky sherbim për persona të ndaluar

Ushqimi të serviret i ngrohët për çdo vakt sipas orarit të përcaktuar.

- Mengjesi ora 07.00 - 09.00,
- Dreka ora 12.00-13.30,
- Darka ora 18.00-20.00.

Në momentin e dorëzimit të ushqimit në prezencë të dorëzuesit dhe pranuesit të ushqimit ndahet një moster ushqimi e cila ruhet në ambientet e sistemit të sigurisë në kushte frigoriferike, të siguruar nga ana e kontraktuesit (firmes fituese),

Afati i ruajtjes së kampioneve është 24 orë dhe vulozet nga mjeku dhe oficeri i rojës.

Sipërmarrësi me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Sektorin Ekonomik çdo muaj për racionet ditore të porositura sipas normave përkatëse, të bazuara në raport forcat e ushqimit të lëshuara nga Shefi i Salles së Komandimit në Drejtorinë Vendore e Policisë Tiranë për Aparatin e Drejtorisë dhe për Komisaritet në vartësi të saj.

Ushqimi i gatuar sipas normave, të shoqërohet me dokument dalje ditore për Drejtorinë Vendore të Policisë dhe Komisaritet vartese.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t'i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menisë javore.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t'i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menisë javore.

Furnizimi me uje, energji, gaz.

- a) Furnizimi me uje, enegji, gaz do te kryhet ne baze te kontratave te lidhura nga kontraktuesi dhe ndermarrjet perkatese furnizuese. Per te garantuar vazhdimesine e sherbimit eshte e nevojshme
 - b) Ne rast nderpreje te burimeve te furnizimit, te vere ne dispozicion burime alternative furnizimi me keto sherbime me mareveshje midis paleve.
 - c) Sipërmarrësi qe do te kryej ketë shërbim, duhet te lidhe kontrate për energjinë dhe ujin e pijshëm, me institucionet përkatëse (OSHEE dhe Ujësjetësin) duke zbatuar te gjitha rregullat dhe udhëzimet nga institucionet përkatëse.
- a. Specifikimet teknike jane pjese integrale e dokumentave te tenderit, te cilat do te plotesohen me cmimet qe ofertuesi do te ofroje. Oferta do te jete ne perputhje me dokumentat e tenderit.
 - b. Cdo ofertues duhet te jape cmimet per RD, dhe per cdo artikull sipas zerit
 - c. Personi i autorizuar per ndjekien e sherbimit do te jete: Shefi i Seksionit te Sherbimeve ne DVP Tirane.
 - d. Operatori ekonomik fitues duhet te siguroje punonjës te kualifikuar dhe me eksperience pune mbi pese vjet si kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier.
 - e. Operatori ekonomik merr përsipër kontrata të rregullta pune për personelin e shërbimit duke kryer pagesat e sigurimeve shoqërore.
 - f. Të gjithë punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me shenja dalluese përkatëse të shoqërisë.
 - g. Operatori ekonomik duhet t'i komplettoj të gjitha mjetet dhe pajisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë.
 - h. Operatori ekonomik do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktor konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme ose është mjaft i pakënaqur nga puna e këtij personi.
 - i. Personeli do të jetë i pajisur me librezat shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.

Përshkrimi i shërbimeve:

- Furnizimi i lendes se pare, përgatitja, gatimi dhe shpërndarja e ushqimit për 3 vakte sipas programit ushqimor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor(Nga Shefi i Sektorit Ekonomik).
- Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave .
- Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.
- Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara në normën bazë të ushqimit dhe menunë javore pa miratuar nga Autoriteti kontraktor.
- Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë konformë normave bazë të ushqimit.
- Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normave bazë të ushqimit

Programi Ushqimor

- Llojshmëria e ushqimit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi dhe menuja e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë të DVP TIRANE në bazë të normave.
- Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menisë ditore të ushqimit sipas programit të miratuar nga DVP Tirane.
- Shërbimi do të realizohet sipas nevojave (kerkeses) të DVPTirane për numrin e të ndaluarve dhe të arrestuarve sipas raportit të forcës të lëshuar nga salla e drejtimit e komandimit për të 3 vaktet ditore.

Shtojca 6

LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI", PËR QENDRËN SPITALORE TË BURGJEVE

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI PER QENDREN SPITALORE TE BURGJEVE		
Nr.	Emertimi	Nr. Racioneve
1	Dieta Nr.1 (Dieta normale) 2 700 k kal (prot100gr, lipide77gr, glucide 420)	91,980
2	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget) 2100 k kal (prot 70 gr, lip.95.3gr, gluc.248.6gr)	1,095
3	Dieta Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget) 2 100 k kal (prot.80 gr. Yndyrna 12gr. Gluc.297gr.	1,095
4	Dieta NR 7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	1,095
5	Dieta Nr. 9 (Dieta per enero-kolite) 2000k kal (prot.70gr. lip.63, gluc.308gr	1,095
6	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike) Kjo diete varion nga 800-3000k kal, Dieta me diabetiket me diabet te ekuilibruar. (2 300 k kal (prot.88gr. lip.92gr. gluc.278gr)	5,475
7	Dieta Nr.14 (Onkologe) Hiperkalorike,hiperproteinike,hiperglucidike e pasur me Ca e Fe 3 000 k kal (prot.122 gr. Yndyrna 108 gr. Gluc. 385gr.)	7,665

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Shtojca 6

**LOTI 2 ME OBJEKT: "SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI",
PËR AKADEMIN E SIGURISË**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER AKADEMINE E SIGURISE		
Nr	Emertimi	Totali racioneve
1	<i>Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Mëngjes</i>	198,075
2	<i>Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Dreke</i>	304,025
3	<i>Ushqim i gatuar e i shperndare për vaftin Darke</i>	172,675

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

SHTOJCA 6**LOTI 3 ME OBJEKT: "SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI",
PËR REPARTIN E NDERHYRJES SË SHPEJTË SHKODËR**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER REPARTIN E NDERHYRJES SE SHPEJTE SHKODER		
Nr	Norma	Shuma e Racioneve
1	Norma me 3 Tre Vakte	21,900
2	Norma me 1 Vakt (Dreka)	47,025

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Shtojca 6

**LOTI 4 ME OBJEKT: "SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI",
PËR DREJTORINË VENDORE TË POLICISË, TIRANË**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER DREJTORINE VENDORE TE POLICISE, TIRANE			
Nr .	EMERTIMI	Njesia	Sasia
1	Ushqim i gatuar e shperndare	rd	38,800

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Shtojca 7

**LOTI 1 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”,
PËR QENDRËN SPITALORE TË BURGJEVE**

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti “Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Qendren Spitalore te Burgjeve”

Operatori Ekonomik fitues duhet te ofroje sherbimin e ushqimit sipas te gjitha rregullave higjensanitare qe nga lenda e pare, pergatitja, gatimi, paketimi, transporti, shperndarja, per 7 (shtate) ditet e javes sipas vakteve te percaktara nga autoriteti kontraktore dhe sipas kerkeses – porosise ditore te QSB-se ne baze te numrit te pacienteve dhe dietave respektive te tyre;

Transporti i ushqimit te gatuar do te kryhet nga Operatori Ekonomik fitues deri tek dera e Regjimit te Brendshem ne territorin e Qendres Spitalore te Burgjeve sipas orareve te servirjes;
Dorezimin e ushqimit brenda te gjitha parametrave ne orarin e caktuar sipas dietave te percaktuara 24 ore mbi 24 ore;

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Spitalore e Burgjeve, Tirane

Shtojca 7

**LOTI 2 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR
AKADEMIN E SIGURISË**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “ Gatim shperndarje ushqimi” per Punonjesit e Policise Shtetit , Studenteve dhe Kursanteve.

Detyrat:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne ambjentet e Akademise Sigurise

Shtojca 7

LOTI 3 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR REPARTIN E NDËRHYRJES SË SHPEJTË SHKODËR

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për një vakt dhe tre vakte në ambientet e Repartit “**Nd.Shpejte**” sipas Programit Ushqimor javor dhe ditor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Detyrat:

- Të sigurojë në kohë dhe me cilësinë e kërkuar, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit..
- Të garantojë në çdo kohë shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas normës për punonjësit e policisë.
- Të sigurojë ushqim të sigurtë për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve (mensës dhe anekseve të saj) me pajisjet e domosdoshme për gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.
- Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit në rastet e daljes së efektivit në terren.
- Të sigurojë kushtet e nevojshme higjieno sanitare për realizimin e shërbimit.
- Të sigurojë shërbim me standarde të larta.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne ambjentet e Repartit te Nderhyrjes se Shpejte, Shkoder.

Shtojca 7

LOTI 4 ME OBJEKT: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR DREJTORINË VENDORE TË POLICISË, TIRANË

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë.

Detyrat:

- Te siguroje furnizimin ne kohe dhe me cilësinë e kërkuar te ushqimit te gatuar.
- Te garantoje ne çdo kohe shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas normës për shtetasit e ndaluar dhe te arrestuar.
- Te siguroje ushqim te sigurve për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet qe mund te shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve (mense e kuzhine) me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.
- Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit per te ndaluarit dhe te arrestuarit
- Te siguroje kushtet e nevojshme higjeno sanitare për realizimin e shërbimit.
- Te siguroje shërbim me standarde te larta.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne ambjentet e Drejtorise Vendore te Policise Tirane, si dhe komisariatet e policise 1,2,3,4,5,6 dhe komisariati i policise Vore.

Shtojca 8

LOTI 1- “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR QENDRËN SPITALORE TË BURGJEVE.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

